

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

BJH-2

M 33




MIROSH MARKAJ

BESA E MADHE

**DRAME**

SH-2  
MI 33


MIROSH MARKAJ



# BESA E MADHE

**DRAMË**

19682



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

V E T A T :

SULË VOKSHI ~  
MET KORONICA  
PRENKË GULIA  
TONI I PRENKËS ~  
MIC SOKOLI +  
ALI PASHË GUCIA ~  
SHPEND HEKAKEQI +  
MEHMET ALI PASHË MAXHARI ~  
ABDULLA PASHË DRENI ~  
ADJUTANTI I SULTANIT ~  
HANMI I PASHËS  
MEHMET ALI DRENI ~  
MRIKA +  
SHAQIR AGA ~  
BAJRAM AGA ~  
PATER PJETRI ~  
HOSHI I NURIT ~  
HASAN BATUSHYA  
SEJMENI I ABDULLA DRENIT ~

HOXHË QITAPI —  
 SILI BOZAXHIU +  
 GANIU +  
 HYSA +  
 MUJË MUHAXHIRI +  
 LAM MUHAXHIRI  
 MALESORE, USHTARE  
 TELLALI E TË TJERË

## **Ngjarja zhvillohet në Gjakovë, më 1878.**

## VEPRIMI I

Gjakovë, më 27 gusht 1878

A. Pamje nga rruga.

Në një krah të skenës një lis i madh rrëzuar përdhe, ndërsa në tjetrin një qoshk me një tendë gjethesh, që i bën hije. Dy tryezat dbe disa karrige: sheqerxhihana e Sili Bozaxhiut.

Dukja I.

Në krahun e qoshkut: Shpendi, Bozaxhiu, Ganiu, Hysa.

- SHPENDI — (Hyn duke mbartur një kosh mbuluar me fier.) O Sili Bozaxhiu!

BOZAXHIU — (Nxjerr kryet nga qoshku.) Urdhëro!

Ti Shpend Hekakeqi je?

SHPENDI — Ta prura borën.

BOZAXHIU — (I del përpara.) Hej, të lumshin këmbët! (E ndihmon ta ulë barrën përdhe. Ganiu dhe Hysa afrohen te qoshku.)

GANIU — Nu k do të ishte keq ta pinim nga një bozë?

HYSA — Edhe ajo na duhej, pak jemi të thartuar.

BOZAXHIU — (Duke u kthyer të porsaardhurve.)

Urdhëroni, myshterinj, sherbet të ftohtë me borë. Urdhëroni!

GANIU — (*Me habi.*) Borë në mbarim të gushtit!

BOZAXHIU — Sapo ka zbritur nga bjeshkët. (*Tregon Shpendin, që është ulur në një karrige dhe fshin djersët.*)

HYSA — Prej nga e ke prurë, o burrë i dheut?

SHPENDI — Nga maja e Shkëlzenit.

GANIU — (*Ulet në karrige.*) Na bjer nga një sherbet me borë, o Sili Bozaxhiu! (*Ulet edhe Hysa.*)

BOZAXHIU — Peqe, myshterinj!

SHPENDI — Deri te Hani i Piskotës e prura ngarkuar në gomar, porse aty nuk desh të më bindej gomari. Oka t'i bëja? E mora në krah... Më lodhi.

BOZAXHIU — (*Nxjerr kryet nga dritarja e sheqer-xhihanës.*) Mos u mërzit, o Shpend! Hekakeqi, veshgjati, veshgjat është. Të kishte pasur mend e bënин pashë. Nuk tha keq ai kopshtari i përrallës. (*I ve përpara paret. Shpendi nxjerr qesen dhe i shtie në të. Dëgjohet një daulle që larg.*)

SHPENDI — Për çka bie kjo lodër, O Sili Bozaxhiu?

BOZAXHIU — Na çau veshët qëmenatë tellalli i hymemetit: do të vijë Mehmet Ali Pashë Maxhari! Do të vijë në sabah, do të vijë në hylë... Po afrohet iqindia dhe Mehmet Ali Pashë Maxhari nuk po duket.

SHPENDI — Kush është ky Mehmet Ali Pashë Magjari?

GANIU — (*Shtrudh.*) Një mik i mbretit.

HYSA — (*Rrëmbyer.*) Armiku i miletit.

SHPENDI — (*I habitur.*) Kjo qenka një punë dreqi: mik i mbretit, anënik i miletit.

**BOZAXHIU** — (*Nxjerr kryet nga dritarja e Agosh-kut.*) Bulkur e the, o burrë i malësisë: kjo pasi<sup>1)</sup> e Maxhar Pashës në Gjakovë është një punë dreqi.

**SHPENDI** — (*Me dyshim.*) Mos vjen me mbledhë pagët e të dhjetat e vitit që shkoi? Ne nuk i kemi larë ende. (*Duke tundur kokën.*) (Kot po llohet, s'kemi veç lëkurëp.)

**HYSA** — Edhe Krajlitë e Evropës me mbretin e Stambollës shi përkëtë punë e kanë nisur Maxhar Pashën: me na rrjepë lëkurën.

**SHPENDI** — (*I befasuar.*) Me na rrjepë!

**HYSA** — (*Ngrihet më këmbë.*) Kështu me na rrjepë e me na nda në katër copa. Sepse, lumë milku, vendi ynë sot ka ngelur, në dorë të krajlive dhe të mbretit si delja në dorë të thertarëve: e presin, e rrjepin, e nxjerrin në treg...

**SHPENDI** — (*I fyjë.*) Çka je kah flet, bre burrë!

**HYSA** — (*I qaset Shpendit dhe i vë dorën mbi sup.*) Nuk flas unë kështu, o trim i malësisë. Kështu ka folur Maxhar Pasha përpëra krerëvë tanë, në Xhaminë e Bajrakut, mu në mes të Prizrenit.

**SHPENDI** — (*Me mlef.*) Dhe ata e dëgjuan duarlidhur. Si nuk u ndodh një burrë të nxirrte taganim dhe t'ia priste kryet.

**GANIU** — (*Qetëson shokun e vet.*) Mos u rrëmbe, bre Hysë, nuk e dimë ende përfill e përpë se çka mund të ketë ndodhur në Prizren.

**HYSA** — E çka, të dijmë më tepëri mbreti na ka nxjerrë në treg të Ballkanit me na shitë.

1) Pasi = vizitë.

**BOZAXHIU** — (Me një tabaka në dorë dhe gotat me sherbet u shërben myshterinjve dhe Shpendit.)

Ashtu është, Hyça ka të drejtë. Mbreti i Stambollit ia ka falur knjaz Nikollës të Malit të Ziqjaشتë shehre të Shqipërisë së Epërme. Dhe krajlitë e Evropës në Berlin i pasqan thënë: «Për hajr të qofshin!»

Tani knjazi gatitet ta sjellë të shoqen, Milenën, bashkë me gocat, në Prizren; se aty ia paska qejfi ta ngrehë selinë e krajlisë së vet.

**SHPENDI** — Pasha qiellin! Le ta zgjasë dorën. Do t'ia shkurtojmë. E lidhëm a s'e lidhëm besën në Prizren?

**HYSA** — E lidhëm, bre burrë i dheut.

**SHPENDI** — Atëherë qka presin krerët e Lidhjes së?

**GANIU** — Krerët e Lidhjes Shqiptare kanë dy javë që japid marrin me Maxhar Pashën, në Prizren... Punët nuk na venë mirë me sa kemi marrë vesh nëpër tevatyrë.

**BOZAXHIU** — Kjo dita e sotme ju ka thartuar shumë, or miq. Prandaj uluni dhe pini nga një sherbet me borë bjeshkësh që të freskoheni dhe të qetësoheni. (Ulen dhe pijnë sherbetin, me ngadalë.)

## Dukja 2

Në krahun e lisit të rrëzuar përdhe Mujë Mu-haxhiri dhe Lam Mu-haxhiri.

**MUJË MUHAXHIRI** — Edhe ti, o Lam, nái paske dali me takua lajmësin e mbretit?

**LAM MUHAXHIRI** — (Me keqardhje.) Hej, or Mujë, unë të dal me takua lajmësin e mbretit! E ku

më lenë rehat sejmenët e begit. Kam drojë<sup>1)</sup> se  
do t'i nixjeriin cullët në rrugë të madhe.

MUJË MUHAXHIRI — E çka do t'i duhen kësollat në  
livadhet e Piskotës Abdulla beg Drenit? Gjëja  
e gjallë ndodhet në bjeshkim.

LAM MUHAXHIRI — Begit ia kënda të më nisi bujk  
me punua në çiflikun e Kavallës.

MUJË MUHAXHIRI — (I kapur befas.) Syrgjin deri  
në Kavallë!

LAM MUHAXHIRI — (I bindur.) Unë nuk largohem  
prej Kosove. Mjaft rrugë të gjatë kam bërë nga  
Vranja në Gjakovë. Më duket se po të shkoj  
më tutje do të humb, do të trëtem si kripa në  
ujë. Muhaxhir' jam këtu, pa plang e pa shtëpi,  
por e ndiej veten në vendin tim.

MUJË MUHAXHIRI — Në vatan.

LAM MUHAXHIRI — Ashtu! (Pas një pshérëtime.)  
Ti, or Mujë, erdhe nga Tivari dhe ua ngrehe  
robve të tu një strehë në Gjakovë.

MUJË MUHAXHIRI — (Me dorë, në zemër.) I qofsha  
falë hoxhë Met Koronicës, që ma dha atë kthi-  
mën te mejetpi!

LAM MUHAXHIRI — Kurse unë.. Më mirë dal këtu  
në rrugëtë Prizrenit dhë ngreh një çadër si  
çergar, se të marr rrugën e Kavallës. S'vete e  
gjithë ishvete.

MUJË MUHAXHIRI — (I hedh dorën mbi sup.) Hej,  
sa qenka pezmatuar, or miku i hallevë! Ulu të  
rrimë dhe ndize një duhan. Mos u tut nga sej-  
menët e Abdulla begit.

---

1) Drojë = frikë.

LAM MUHAXHIRI — Unë nuk tutem... më vjen bezdi... (Ulen që të dy pranë lisit të rrëzuar dhe dredhin nga një cingare.)

Dukja 3

Sejmeni i Abdulla Drenit dhe Bajram Aga hyjnë nga mesi i skenës.

SEJMENI — Pa shiko, o Bajram agë, krejt Gjakova paska dalë me pritë të dërguarin e mbretit. (Gati sikur këndon):

*Lum e lum po ban mileti  
për një mik që n'a çon mbreti.*

BAJRAM AGA — (E miraton.) Me të vërtet shumë milet paska dalë në rrugë të Prizrenit.

SEJMENI — (Vazhdon përsëri si duke kënduar):

*Kah asht nisë ky mik u i mbretit?  
Në konak të Abdulla begit.*

BAJRAM AGA — Të ardhka ndoresh me qitë bejte, o sejmeni i begit.

SEJMEN — Evet<sup>1)</sup>; Bajram agë. E kam nga gjëzimi. Vetëm se Abdulla begit duhet t'i themi Abdulla pashë Dreni, ashtu si duhet të të themi edhe ty bimbash Bajram agë Gashi...

BAJRAM AGA — (Si duke qeshur.) Paska qenë hoktar.

SEJMENI — A nuk ta ka premtuar nishamin e bimbashit Mehmet Ali Pasha?

---

1) Evet (tve) = ashtu

BAJRAM AGA — Thua se do ta mbajë fjalën?

SEJMENI — Domosdo. Dashamiri ynë, Abdulla pashë Dreni; e ka mik të ngushtë Mehmet Ali Pashë Maxharin. Kush i ngriti bejlerët tanë dhe i bëri pashatlarë? Dorë e djathëtë e padishahut, Mehmet Ali Pasha. Edhe kësaj here sultani e ka nisur Mehmet Ali Pashën pér në vilajetin tonë me një premtim të madh: «Po që solle në udhë miletin e Arnautlëkut do të të bëj vezir dhe do të fal një çiflig të madh më të dalë të Stambollit.» Edhe ne që do t'i bëhem i krah mikut të mbretit, nuk do të mbetemi pa gjë: ti bimbash, unë kajmekam.

BAJRAM AGA — I qutë je, bre Masar agë.

SEJMENI — Melhem pér plagë. (*Bëjnë disa hapa pérpara.*)

Dalja 4

*Bajram aga, Sejmeni, Mujë Muhamxiri, Lam Muhamxiri, Bozaxhiu.*

LAM MUHAMXIRI — (Mënjanë.) Ku na dolën pérballë, dreqi t'i marrë!

BAJRAM AGA — Merhaba, o Lam Muhamxiri! (Afrohet te Muhamxirët.) Mos është Mujë Muhamxiri, nga Tivari, ky miku yt.

LAM MUHAMXIRI — Ai vetë.

BAJRAM AGA — Qolsh me shëndet, o Mujë Muhamxiri,

MUJË MUHAMXIRI — (Përshëndetet me) Bajram agën.) Tungjatjeta!

BOZAXHIU — (Te derave shëqerxhikanës.) Urdhëroni, myshterinj! Bozë të ftohtë, sherbet me borë, dundëрма; dhjetë pare! Badiava!. (Shkon të

*shtrojë një tryezë me katër karrige.) Urdhë-  
roni myshterinj!*

BAJRAM AGA — Uluni, bre miq, të flladitemi me  
ngá një pije të ftohtë.

MUJË MUHAXHIRI — Të falëmi nderës!

SEJMENI — Sot do të paguaj unë, Bajram agë. Ti na  
kë ardhur si mik.

BAJRAM AGA — Nuk është ndonjë harxh i madh.  
(*Bózaxhiut.*) Mua më bjer një sherbet me bo-  
zë, bjeshike.

MUJË MUHAXHIRI — Ne të dyve nga një bozë.

SEJMENI — Unë dua dundërmë. (*Ulen rrëth tryezës.*)  
Vapë e madhe.

BAJRAM AGA — Vapa sot kë filluar qysh në më-  
ngjes, sapo doli dielli. (*Qetësi! Që larg dëgjohet*  
*zëri i myezinat: «Allah iqber!»*)

SEJMENI — Mulla Kamberi po i thërrret besnikët  
me u falë për qindi.

BAJRAM AGA — Qysh e duroni këtë ufëm!

BOZAXHIU — (*Duke u shërbypër.*) Shumë herët të  
paskë marrë malli për borën e bjeshkëve,  
Bajram agë.

SEJMENI — Po ta kesh qesen plot e ke borën në  
shtëpi.

BOZAXHIU — Paraja ngrë ujët përpjetë, si mos ta  
zbresë borën tatëpjetë!

BAJRAM AGA — Prej nga je ti, o Sili Bozaxhiu?

BOZAXHIU — Prej Rekës së Dibrës, o bajraktar.  
Kam njëzet vjet që kam zenë vend në Gjakovë. Në fillim më thërrisin Sili Bagëri, si-  
paç zanatit të pleqve...

SEJMENI — Gjakovë të njeh për bozaxhi dhe të thë-  
rrret Sili Bozaxhiu.

**BAJRAM AGA** — Unë të njoh mirë, o Sili Bagëri, por desha të njohin edhe këta miqtë muahixirë. Reka e Dibrës ishte vatani yt i vjetër, Gjakova, eshtë vatani yt i ri. Domosdo vendi që të mban bëhet vatan.

**BOZAXHIU** — (*Me keqardhje.*) Malli dhe gjëja nuk na mbante në Rekë. Edhe kur ishte moti i mbarë, zbriste Luma dhe na bëhej gjysmatare. (*Bajram aga nxjerr qesen të paguajë.*) E ku nuk i gjen rekallinjtë tanë sot: në Stamboll, në Sofje, në Bukuresht... Kur u ngrit Lidhja Shqiptare në Prizren erdhi nga Stambolli bashkë me Abdyl Toskën, Pashko Vasë Shkodranin edhe një miki i tim ungji, Gjon Vreta ia thoshin emrin. Ai bujti në shtëpinë time.

**BAJRAM AGA** — Në njëzet vjet me një ibrik bozë ngrite shtëpi e dyqan.

**SEJMENI** — Këtij i thonë kësмет.

(*Ngrihen tē gjithë më këmbë. Bozaxhiu mbledh gotat.*)

**BOZAXHIU** — Kësметi nuk vjen avash-avsh duke punuar si rob, kësметi vjen në një hop, me një ferman dhe ta ngjit në gjoks një nishan: të bën bimbash, kajmekam. (*Shkon e hyn në sheqerxhiane.*)

**SEJMENI** — (*I mërzitur.*) Ku i ke marrë vesh këto fjalë, o kauri i Dibrës?

**BOZAXHIU** — (*Nga dritarja.*) Nuk ka të fshehtë që të mos merret vesh në këtë vend. Miletit ta këndon pusullën më xhep, Masar agë.

**SEJMENI** — Karvani të na shkojë përpëra...

**BAJRAM AGA** — Sheqerxhi shakator. (*Lam Muha-*

xhirit.) O LAM Muhaxhiri, mos i bjer së mirës me këmbë; nisur për në Kavallë. Atje është kësметi yt: A e dëgjon si fletrekalliu? E ka syrin pishë, ndonëse është jabanxhi në Gjakovë.  
**LAM MUHAXHIRI** — Dibër e Gjakovë janë afër...  
**BAJRAM AGA** — Kavalla është truall i mbretit, Turqi.

**SEJMENI** — Shqipëria është vatani ynë i vogël, Turqia vatani ynë i madh. Jarebi shyqyr, që ndodhëm turq.

**BAJRAM AGA** — Atëherë mblidhuni rrëth meje, o muhaxhirë, t'ju shkruaj: ushtarë me rrögë në taboret e mbretit. Të nisemi dhe të marrim trojet e humbura.

**LAM MUHAXHIRI** — Ne u nisëm vetë një herë, që të merrnim trojet e humbura, por askeri i do-vletit na la në balte.

**MUJË MUHAXHIRI** — Nuk na rrejnë më fjalët e bukurë.

#### Dukja 5

Prenkë Gulia dhe Hasan, Batusha hyjnë nga mesi i skenës.

**HASAN BATUSHA** — Tani ju kaurët duhet të gëzoheni, o Prenkë Gulia.

**PRENKË GULIA** — E pse të gëzohemi, o Hasan agë?

**HAŞAN BATUSHNA** — Sepse ky Maxhar Pasha është kaur si ju.

**SEJMENI** — *Stafkurullah!*

**BAJRAM AGA** — Po na çudit, o Hasan agë Batusha.

**HASAN BATUŠA** — Edhe unë u qudita, kur dëgjova, por kështu është; prandaj i thonë maxhar, se është kaur. (*Të gjithë kthehen të quditur kah Prénkë Gulia dhe Hasan Batuša.*)

**PRÉNKË GULIA** — (*Shtruar.*) Se çfarë feje është nuk e di. Por unë them se ky njeri, po të vijë për të mirën tuaj, do të vijë edhe për të mirën tonë, po të vijë për të keqen tuaj, do të vijë edhe për të keqen tonë. Ne jemi shqiptarë të një gjaku. Dhe ai vjen i huaj, dërguar prej të huajsh: prej gjashtë krajlive të krishtera të Evropës dhe prej mbretit mysliman të Stambollit shtatë. Ne të qëndrojmë njeri pranë tjetrit si vëllezër të pandarë; vetëm kështu do ta mbajmë më këmbë Lidhjen Shqiptare. (*Dëgjohet lodra duke u afruar.*)

**HYSA** — Kështu, o Prenkë Gulia. (*E miratojnë edhe të tjérë.*)

**TELLALLI** — (*Hyn duke i rënë lodrës.*) Hej, mileti i Gjakovës, dëgjoni e mbani vesh! Mehmet Ali pashë Maxhari nuk vjen sot në kazanë tonë, se ka ndodhur një gjurulldi e madhe në çarshinë e Prizrenit. Prandaj kajmekani ynë, Xheladim beu, me fjalën e Hafëz Pashës, valiut të Kosovës, bën hyqëm të shpërndahet mileti nëpër shtëpi pa fjale e pa gjurulldi. (*Vazhdon t'i bjerë lodrës duke dalë.*)

**HYSA** — E si të shpërndahemi, bre burra? Prizreni ka marrë flakë... Në duhet të bashkohemi.

**GANIU** — Të bashkohemi dhe t'i presim hovin këtij dushmani.

**MUJË MUHAXHIRI** — Ndryshe ky Maxhar Pasha do t'i nxjerrë të gjithë shqiptarët muhaxhirë.

**BOZAXHIU** — (*Prenkë Gulisë.*) Si t'ia bëjmë, o my selimi ynë?

**PRENKË GULIA** — Ne nuk shpërndahemi, do të dalm me pritë Sulejman agë Vokshin, që kthehet nga Prizreni. Qe ku po vjen im bir, Toni. (*Sejmeni dhe Bajram aga drejtohen, të dalin nga ana e lisit të rrëzuar përdhe, pas tyre Hasan Batusha, të tjerët presin Tonin.*)

## Pamja 6

*Toni i Prenkës, pas tij Sul Vokshi dhe Met Koronica të ndjekur nga disa malësorë, më vonë Tellalli.*

**TONI I PRENKËS** — Po vjen Sulejman agë Vokshi, Hoxhë Met Koronica... Sapo, ju kthyen nga Prizreni.

**SEJMENI** — O Bajram agë, të shkojmë në sarajet e Abdulla pashë Drenit. Atje do të gjejmë patjetër ndonjë lajmës.

**BAJRAM AGA** — Nuk e ke keq! Abdulla pashë Dreni do të na ketë çuar fjalë... Jakë me tie, o Hasan agë! (*Dalin.*)

**HASAN BATUŠHA** — Të dëgjojmë çka na thotë Sulejman agë Vokshi.

**SUL VOKSHI** — (*Duke hyrë.*) Mirë se ju gjej, or burra!

**TË GJITHË** — Mirë se vjen, o Sulejman agë Vokshi! (*Përshëndeten.*)

**PRENKË GULIA** — Edhe ti, kadi efendi, paske qenë në Prizren? Nuk e dija.

**MET KORONICA** — Unë dola me e takue Sul Vokshin deri te ura e Fshajtit, se nuk më pritej. Ti e di, o Prenkë Gulia, sa i padurueshëm jam unë.

PRENKË GULIA — Për lajmet e Prizrenit të gjithë jemi të padurueshëm.

HYSA — E si të shkoi puna atje në Prizren, o Sulejman agë Vokshi?

GANIU — Si u ndatë me Maxhar Pashën?

MET KORONICA — Fol, or Sul Vokshi, se këtu jemi gjithë tamët.

SUL VOKSHI — Mehmet Ali pashë Maxhari erdhi nga Stambolli me qëllim që ta prishë Lidhjen Shqiptare. Si nuk ia doli me e prishë e përcau.

PRENKË GULIA — Nuk duhet të përcahemi kurresi. Ne e ngritëm Lidhjen Shqiptare të gjithë për nji, pér Shqipëri.

MET KORONICA — E po ja që na përgau, o Prenkë Gulia.

SUL VOKSHI — Ne, krerët e vegjelimit, nuk kemi luajtur nga besa që lidhëm në Prizren dhe do të qëndrojmë deri në fund pér të mbrojtur trojet tona. Disa nga krerët e parësimit kanë luajtur nga besa; ata duan t'ia lëshojnë Plavën e Gucinë Malit të Zi.

MET KORONICA — Kurrën e kurrës!

TË GJITHË — Kurrën e kurrës!

GANIU — Punë që s'bëhet.

SHPENDI — Vdesim e nuk e lëshojmë.

TONI I PRENKËS — Këtë marre askush s'e do, këtë faqe të zezë gjithkush e dro, thotë Pashko Vasa.

SUL VOKSHI — (*I vë dorën në sup Tonit të Prenkës.*) «Ne u mblodhëm në këtë kuven që të lidhëm besën shqiptare dhe të betohemi se do t'i mbrojmë me gjak trojet, që na kanë lënë trahëgim të parët tanë», tha Abdyl beg Toska,

në Prizren. Dhe ne nuk e shkelim këtë be të rëndë. Nga trojet tona nuk lëshojmë asnjë pëllëmbë.

**TË GJITHË — Asnjë pëllëmbë!**

**SUL VOKSHI —** (*Duke hedhur një sy rrëth e rrrotull.*)

A e dini se kush i doli krah Maxhar Pashës, atje në Prizren këto ditët e pramie, or burra?

A e dini se kush don t'i prijë kah Plava e Guacia të dërguarit të mbretit? Abdulla Pashë Dreni, kryetari ynë! (*Murmërimë çudie.*)

**PRENKE GULLIA —** Si është e mundur, o Sulejman agë Vokshi!

**MET KORONICA —** Unë nuk çuditem, or miq e shokë. Abdulla Drenit i kanë pëlqyer gjithmonë nishanet. Ai i ka pritur me dorë në zemër të gjitha fermanet e padishahut, ndryshe nuk bëhej pashë, por dilte kaçak malit si ti, Sulejman agë Vokshi.

**SUL VOKSHI —** Ne nuk e ngritëm Lidhjen Shqiptare për nishane, as për ofiqe dhe çifligje, por për Shqipëri. Prandaj që tashti do të lëshojmë kushtimin në Rrafsh e në Malësi: «Kush është trim prej shtatë deri në shtatëdhjetë vjeç të marrë hutën në dorë dhe të zgresë në Gjakovë, se Lidhja Shqiptare ndodhet në rrezik!» (*Dëgjohet përsëri lodra. Të gjithë drejtohen nga tellalli që hyn.*)

**TELLALLI —** Hej, millet! Hyqymeti i Gjakovës!...

**MET KORONICA —** (*Turret dhe i heq lodrën.*) Hyqymet në Gjakovë jemi ne, o tellall i dovletit... Shporru që këtej. (*Hysës.*) Merr këtë lodër ti, o Hysë, dhe jep kushtimin të mblidhet trimëria e Gjakovës që tashti në sheshin Terzianës.

**HYSA** — (*Merr lodrën dhe i bie.*) Hej! Dëgjoni e mban  
ni vesh kushtrimin e Lidhjes Shqiptare, në  
Gjakovë: Kush është burrë, prej shtatë deri  
më shtatëdhjetë vjeç, me hutë në dorë, t'ur-  
dhérojë në sheshin e Terzihanës, për kuvend!»  
(*I bie përsëri lodrës me një ritëm valleje.*)

**PRENË GULIA** — Me këto lodra nuk do të mbetet  
shqiptar pa hyrë në valle, o Sulejman agë  
Vokshi.

**SUL VOKSHI** — Lum kush hyn në vallen e miletit, o  
Prenë Gulia! (*Të tjerëve.*) Të shkojmë në ku-  
vend, or burra! (*Dalin.*)

### **Dukja 7**

Këngëtari më lahutë, (ulur mbi lisin e rrëzuar  
përdhe:)

*Të shtatë krajlat kuvëndojnë,  
Për Prizrenin shka po thonë?  
Mehmet Pasha i Maxharit,  
Mik i mbretit, mik i kralit,  
Te xhamia é Bajrakut,  
Ja këndoi fermanin hallkut,  
Një ferman të zi Stambolle,  
Me ja lëshua knjaz Nikollës  
Trojet tona Plavë e Guci...  
Gjami e madhe për Shqipni!*

(*Bie sipari në tingujt e lahutës.*)

## VEPRIMI II

B. Pamja nga shtëpia e Prenkë Gulisë.

Kthina e miqve me një vatër në mes. Në krahun e majtë një mesdre (1) she ndonjë shkallë që të nxjerr në kurtin (2) e shtëpisë përmjet një dëre. Një derë e dytë të lidh me brendinë e shtëpisë, ashtu si edhe një mesore e dytë më të djathtë, që niste nga pareti përballë, ku ndodhet një dritare. Në paretin e djathtë është vendosur një dërrasë e zezë, ku është shkruar qartë: «O moj Shqypni, e mjera Shqypni!» dhe më poshtë: «Çoniu shqyptarë, prej gjumit, çoniu — Të gjithë si vllazën më nji besë shtrëngoni!» Disa shkambinj e frona.

Dukja 1

Nëpër errësirë dëgjohet troku i një kali, hingëllima e tij. Zhurma e cikrikut dhe e ujit që rrjedh... Mic Sokoli, Prenkë Gulia, Toni i Prenkës.

---

1) Mesore = korridor.

2) Kurt = Oborr.

MIC SOKOLI — (Që jashtë.) O i zoti i shtëpisë, o Prenkë Gulia!

PRENKË GULIA — (Hyn nga mesorja e djathë me një kandil.) Kush je ti?

MIC SOKOLI — (Përsëri që jashtë.) Një kaçak mali. A pret miq?

PRENKË GULIA — (Shkon dhe hap derën e kuftit.) Shtëpia e shqiptarit e mikut dhe e shtegtarit. Urdhëro!

MIC SOKOLI — (Hyn Brendë.) Mirëmbrëma!

PRENKË GULIA — Mirë se erdhe dhe të lumtë këmba! (Past e ka njohur) Por ti nuk je në derë të mikut, o Mic Sokoli, ti je në derë të fisit. Unë Nikaj e ti Krasniq, trungu dhe dëga e një lisi.

MIC SOKOLI — (Past përshëndetet me të zotin e shtëpisë.) Prandaj unë nuk trokita në portën e madhe.

PRENKË GULIA — Edhe unë ta dëgjova që larg trokun e kalit. Pa kur hyre në kurt dhe u ndale me mbushë ujë të pusi: «Ky do të jetë njeri i shtëpisë», thashë me vete. (Vendos dritezën mbi vatër.) A je lodhur?

MIC SOKOLI — Më tepër më ka lodhur vapa e rënë dë se rruga e gjatë. U ndala të flladitem dhe të shkëmbëj një fjalë me një mik të zemrës kështu më këmbë... Më pret një rrugë edhe më e vështirë. Duhet të nxitoj që të jem nesër në mëngjes në Malësi.

PRENKË GULIA — (I jep një shkamb.) Ulu e shplogdhuh se ke kohë. (Bën disa hapa nga mesorja e djathë.) Ore Ton, eja në kthinë e miqve, se kemi një shtegtar!

MIC SOKOLI — Kot po e zgjon çunin nga gjumi.

PRENKË GULIA — Nuk jemi ratë.

MIC SOKOLI — Unë kujtoja se do të ishit në gjumë.  
Druhesha mos ju prish qetësinë.

TONI I PRENKËS — (*Hyn dhe përshtendetet me mikun.*) Tjetërku shna e ka prishur gjumin sone, o Mic Sokoli. Ti mirë se erdhe...

MIC SOKOLI — (*Duke e përshtendetur.*) Mirë se të gjeta, o mësuesi i qunave. Mua kështu ma këndë me të thirrë. Të tjerët le të të thonë reshper i Gjakovës.

TONI I PRENKËS — Edhe mua kështu ma këndë të të dëgjoj.

PRENKË GULIA — Ne tashti pas mesit të natës erdhën në shtëpi. Sapo e ngritëm tryezën e bukës... Por do ta shtrojimë përsëri.

MIC SOKOLI — Nuk më shkon asgjë vëç ujit të ftohë të.

PRENKË GULIA — Ore bir, silli Micin një gojë bukë, pastaj shtjeri edhe kalit një trastë më tagji... Deri në Krasniqe rrugë është e gjatë...

MIC SOKOLI — Kot po ma sjell tryezën... Nuk di se si jam sonte: gabzheri më është lidhur nyje në parzëm, gojën e kam të hidhur vrer. (Toni del.)

PRENKË GULIA — Dy kafshatë bukë të ngrohtë kollomoqi me djathë e një tas dhallë ta lan e ta pastron zhulin e gojës.

(Toni lthehet me tryezën e bukës dhe del përsëri.)

MIC SOKOLI — Ty të qofsha falë, o Prenkë Gulia. Paq derën e çelur dhe t'u rritët ndera... Porse sot ka qëlluar një ditë e mbrapshtë, që na helmoi tejsëtejmi. Angrrat<sup>1)</sup> e kraharorit e të

1) Angrrat = të brendshmet

barkut i kam plot me vrer. (*Tregon taganin, që ka për brézi.*) Sikur të më prisje me këtë tagan, nuk do të më delte prej dejsh gjak i kuq, por vrer i zi.

**PRENKE GULIA** — Morëm vesh se ti, o Mic Sokoli, ishe trazuar mbi të gjithë, atje përparrë xhamisë së Bajrakut... Ti kishe zhveshur taganin dhe i qe vërsulur Maxhar Pashës, bre burrë! (*Toni kthehet përsëri.*)

**MIC SOKOLI** — Nuk munda ta duroj. Kur njai i dërguari i mbretit shpalli fermanin për t'i dorëzuar trojet toma, krejt polemi i Prizrenit u tra-zaua dhe u turbullua si Drini në buenë<sup>1)</sup>. Unë qeshë vetëm një shkulm. U sula ta rrëmbej dhe ta mbyt, por s'më lanë Shaqir aga dhe Abdulla pashë Dreni.

**PRENKE GULIA** — Mirë bëne.

**TONI I PRENKES** — Si paskan bërë mirë, or tatë!... Mandej, o Mic Sokoli?

**MIC SOKOLI** — Maxhar Pasha shpëtoi nga turma e zemëruar, se ja behën suvarinjtë dhe e shpërndanë milletin, por telegrafisti i tij, mjë farë Sokrat Argjiridhi, e pësoi. Ai doli me shëtitë rrugëve, shkoi deri te kafehana e Marashit. Atje u përfol me Ramadanin e Zaskocëve... Djaloshi ynë nuk e duroi: rrëmbeu kapakllien dhe e vrau në vend.

**TONI I PRENKES** — M'i lumtë dora trimit të Zaskocëve!

**MIC SOKOLI** — Mirë, mirë... Por atëherë krërët e parësimit i nisën një dërgatë Maxhar Pashës me e ngushëllua. Në krye të saj u vu Abdulla

1) Buenë = përmbytje, vërshim

lla pashë Dreni, kryetari ynë. Ai e ftoi të dërguarin e mbretit, në Gjakovë.

**PRENË GULIA** — (Me hidhërim.) E morëm vesh, Na e tha Sulejman agë Vokshi.

**TONI I PRENKËS** — Abdulla pashë Dreni nuk duhej ta grishte në shtëpi të vet këtë armik të Lidhjes Shqiptare.

**MIC SOKOLI** — Abdulla pashë Dreni mund t'i prijë mikut deri në sarajet e veta, më tej Maxhar Pasha nuk bën asnjë hap.

**TONI I PREKËS** — Ashtu, o trim i Malësisë: asnjë hap.

**PRENË GULIA** — (Shtruar.) Të shohim se si do të venë këto punë, or çuna. Të presim... Sa për ato që ndodhën në Prizren, unë ju them se n'atë trazirë... më mirë që nuk mbërrite deri te Maxhar Pasha; ó Mic Sokoli. Mehmet Aliu ka shumë miq ndër krenët tanë. Vrasja e tij do ta zemronte sulltanin dhe do t'na përqante përfundimisht.

**TONI I PRENKËS** — Prapë si Dullë Dreni, or tatë! Ai thotë se po të humbasë Turqia nuk ka si shpëton Shqipëria. Turqia është duke u shembur, prandaj të shkëputemi sa më parë prej saj.

**PRENË GULIA** — Perandoria Osmane nuk është aq e dobët sa thonë gazetat, ku shkruan edhe ti, o biri im. Unë i kam shkelur përpëra teje rrugët e tregtisë... Ne duhet të mbështetemi te Porta e Lartë edhe për disa vjet, sa të ngrihem më këmbët tona. Kështu thonë krenët e Komitetit të Stambollit: e para, të mblidhen trojet e Shqipërisë më një vilajet. Kjo tash për tash miafton. (Mic Sokoli ndjek me vëmen-

*dje bisedën duke ngrënë bukë.)* Një vilajet shqiptar më qeveritarë vendës, me shkolla shqipe, me ushtri shqiptare, o Mic Sokoli. Bujqësia, zejtaria, tregtia do të ngrihen nga balta, ku kamë rënë dhe do të tumbaren në rrugën e përparimit. Rrugë të reja do të lidhin qytetet, do të zbresin luginave të lumenjve të na lidhin me detin, me Evropën.

**TONI I PRENKËS** — (*Vazhdon fjalën i ngashëryer.*) Ashtu si thotë miku ynë i Shkodrës, Zef Ju-bani: një udhë hekuri luginës së Drinit, që të lidhë Kosovën e Rrafshin me Shëngjinin; një udhë hekuri e dytë luginës së Shkumbinit; një e tretë luginës së Vjosës. Vetëm kështu Shqipëria do të bëhet vilajet i begatë, i qytetëruar. Tregtia do të rrjedhë nga rrafshnalta në luginat deri në bregdet: qytetet e lashtë të Arbërisë do të rilindin; fushat plot më grurë dhe misër, kodrat e malet me tufa gjethesh, delesh e dhish; pyjet me lëndë bredhi, ahu; nëntoka më xehe<sup>1)</sup> thëngjilli, hekuri, bakri. *Terra mirabilis Albaniæ!*

**PRENKE GULIA** — Ashtu, o biri im: rruga e begatisë është rruga e lirisë.

**TONI I PRENKËS** — Tepër e gjatë dhe e pasigurt, o tatë. Unë i kam shkelur rrugët e tregtisë këto tre vjetët e prasmë dhe mund të them se pa-pritür kohët kanë ndryshuar shumë! Po nuk lëvizëm nga vendi, po nuk u ngritëm me armë në dorë, të gjitha këto, endrra dhe shëstime<sup>2)</sup>

1) xehe = minéral;

2) Shëstim = plan;

të bukura do t'i mbulojë pluhuri, harrimi... Perandoria Osmane nuk është një nënë që u jep kombeve të saj dorën me u ngritë më këmbë, ajo është një përbindësh, që orvatet të mbajë veten gjallë me mishin, me gjakun tonë.

**PRENKË GULIA** — E di, or bir, e di, por duhet të jemi të matur.

**MIC SOKOLI** — (*Dist i habitur dhe me të qeshur.*)

Unë nuk po ju marr vesh, o i zoti i shtëpisë. Ma bëtë mendjen lesh e li me udhë hekuri, me përbindësha, më dhen e me dhi...

**TONI I PRENKES** — Ke të drejtë, o Mic Sokoli... Ta-ta im thotë se kjo vjeshta e Turqisë do të mba-jë gjatë, sa të vjelim kollomoqin, rrushin, mollët, dardhat... Umë them se vjeshtës së Turqisë nuk i dihet: një rrebesch i parë këtu e një vit na rrëmbeu një copë të Shqipërisë, tashti një rrebesch i dytë po turret me na rrëmbye një copë tjetër...

**MIC SOKOLI** — Njimë të marr vesh, o mësues i çunave.

**PRENKË GULIA** — (*Të birit.*) Ty të kanë ndezur fjalët e shkodranëve. Ata kanë vendosur mos ta lenë Maxhar Pashën as me hy në Shikodër, por ta vrasin bashkë me yalinë dhe të marrin pushtetin e vendit, në dorë.

**MIC SOKOLI** — Ne nuk do ta lemë të gjallë ta nisë atë rrugë...

**TONI I PRENKES** — Kështu, or trimi i maleve.

**MIC SOKOLI** — Nesër ndajnate a pasnesër në mëngjes unë kthehem në Gjakovë me gjithë malësorët ngjeshur në armë. (*Ve duart në brez.*)

Qé ku i kam dy gjarpérushét<sup>1)</sup> e bajraktarit  
me dhanë kushtrimin.

PRENKE GULIA — (I habitür.) Shaqir aga ti dorë-  
zoi dy calinat e veta me dhanë kushtrimin në  
malësi? MIC SOKOLI — Kush tjetër! (Shkul armët nga sy-  
lahu.) Bajraku i njeh gjarpérushét e të parit  
të fisit.

PRENKE GULIA — (Si i lehtesuar.) M'a ngrohe ze-  
mrën, o Mic Sokoli.

MIC SOKOLI — Edhe mua m'u ngroh zemra nga ky  
kuvend; nga kjo darkë miqsh. (Vendos calinat  
në brez.)

PRENKE GULIA — Urdhéro e ha bukë!

MIC SOKOLI — Të falemnderit, mbarova. (Ngrihet  
më, këmbë.) Kjo është kthina e mësonjëtore  
sate, o Toni i Prenkës. (I afrohet dërrasës së  
zezë.) Shka ke shkruar në këtë dërrasë të ze-  
zë?

TONI I PRENKËS — (Lexon:) O moj Shqypni, e  
mjera Shqypni!...

MIC SOKOLI — (Bie në mendime.) O moj Shqypni,  
e mjera Shqypni... Kur dola në mbrëmje nga  
Prizreni nata ishte e errët pus... Deri aty në  
Krushë të Madhe qeshë ende i turbull' nga  
ndeshtrashat<sup>2)</sup> e ditës. Por n'atë jerm e klla-  
pi nuk dij se qysh m'u kujtuan këtò fjalë të  
mikut tuaj Pashko Vasë Shkodranit. Qé këtu,  
në këtë kthinë, përpëra tre muajsh, i pata dë-  
gjuar prej gojës së tij...

PRENKE GULIA — Ashtu ka qenë, nuk e paske ha-  
truar.

1) gjarpérushe = calinë, pisqollë.

2) Ndeshtrashat = peripetitë.

**TONI I PRENKËS** — Burra si Abdyl beg Toska, Gjon Vreta, Pashko Vasë Shkodrani, po i pe dhe po i dëgjove një herë, muk i harron për sa të jesh gjallë.

**MIC SOKOLI** — Sa mirë që ja u mëson çunave këngë e Pashko Vasës, o Toni i Prenekës. Atë natë ai na tha shumë fjalë, që na prekën në zemër; por mua m'u ngulitën vetëm këto: «*O moj Shqypni, e mjera Shqypni!*» Vrapoja mbi kalë nepër terr e thërrisja: «*O moj Shqypni, e mjera Shqypni!*» Vrapoja nepër terr e desha të ingre gjëmën: «*O moj Shqypni, e mjera Shqypni!*»

**TONI I PRENKËS** —

*O moj Shqypni, e mjera Shqypni,*

*Kushi të ka qitë me krye në hi?*

*Ti ke pasë kenë një zonjë e randë,*

*Burrat e dheut të thirrshin nanë.*

**MIC SOKOLI** — (*I mallëngjyer.*) Nanë!... Të kisha qenë çun i njomë do të vija në mësonjëtoren tënde me nxanë shkrim e këndim shqip.

**TONI I PRENKËS** — Shkrim e këndim shqip, do të nisin me nxanë të mitur e të rritur, o Mic Sokoli.

**MIC SOKOLI** — Heu! Unë s'kam nge të rrij këtu, se këtë këngë të Shqipërisë do ta nxeja me e këndua me lahutë.

**TONI I PRENKËS** — Do të ta mësoj unë, kur të kthehesh në Gjakovë. Tashti që po merr rrugën e Malësisë për kushtrim, do të thërrasësh me të madhe:

«Coniu shqyptarë, prej gjumit, coniu,  
Të gjithë si vllazën në nji besë shtërgoniu!»

Kështu ja fillojmë që sonte mësimit të gjuhës shqipe.

MIC SOKOLI — (*I ngazellyer.*) Sa bukur, o Toni i Prenkës, kjo fjalë i shkoka për shtati trazimit të ditës dhe vraptit tim kah Malësia:

«Coniu, shqyptarë, prej gjumit, coniu,  
të gjithë si vllazën në nji besë shtërgoniu!»

TONI I PREKËS (*Shpërthen:*) Të lumtë! Le të jehojnë udhës sate këto fjalë si potere calinash.

MIC SOKOLI — (*Përshtendetet me Prenkë Gulinë.*) Të mirë mbetshi, o vëllezër!

PRENKE GULIA — Udha e mbarë!

TONI I PREKËS — (*Përshtendetet me Mic Sokolin.*) Mirë se të vish! (Kalojnë nëpër mesore me shkandil në dorë dhe dalin në kurt të shtëpisë.

Dëgjohet hingëlima e kalit.)

PRENKE GULIA — Falëmëshëndet atij fisi!

MIC SOKOLI — Mirupafshim, o mësuesi i çunave!  
(Dëgjohet troku i kalit duke u larguar, drita shuhet ngadalë dhe ndizet përsëri. Melodi me lëhatë.)

**Dukja 2** (Duke u larguar nga këtu, duke u larguar nga këtu)

Patër Pjetri, Mrika.

PATER PJETRI — (*Hyn nga dera e jashtme, duke ngulçuar në mesore.*) Vapë e madhe, ufëm!<sup>1)</sup>

1) Ufëm = zagushi.

(Fshin ballin e djersitur me shami.) Laudetur Jesus...

MRIKA — (Hyn nga dera e brendshme.) Mirë se të ka prurë zoti, Patër. Pjetri. (Ai i jep dorën, ajo ia puth.) Qenke lodhur.

PATER PJETRI — Rrugë e gjatë... vapë gushti... Me të shkrepur dielli të shpërthejnë djersët. (Pasi shikon rrötull.) Ku i paske trimat, moj nus' e Tonit?

MRIKA — Jänë ngritur qëmenatë dhe kanë shkuar në kuvend me krerët e Lidhjes.

PATER PJETRI — Kështu na qenkan punët. Ditën trëgtojnë lëkurët e leshin, natën kuvendojnë si e qysh ta qeverisin vilajetin. Nga mejtepi në teqe të shehit, nga Rrafshi i Dukagjinit në fushën e Shkodrës japid marrin për Itifakun...

MRIKA — Për Lidhjen Shqiptare, kështu i thotë Toni.

PATER PJETRI — (Si me tallje.) Anima kush e njeh pér Lidhje të Shqiptarëve, moj bijël! (Pasi ka vënë re dërrasën e zezë.) Këtu në kthinën e miqveipo e mban ngrehur mësonjëtoren verore të shqipes Toni yt. Në mëngjes tregton, pashite, mëson. Bukuri! ... A vijnë shumë çuna me nxanë shqip?

MRIKA — Vijnë, se janë me pushime.

PATER PJETRI — Të krishterë?

MRIKA — Edhe muhamedanë: Çuni i Abdulla Drenit, Mehmet Aliu, çuni i Hasan Batushës, çuni i Islam Batushës...

PATER PJETRI — Shka thua!... Ja paska marrë nxënësit e parisë hoxhë Ahmet Koronicës. Qysh tani nuk zemërohet hoxhë efendia!

MRIKA — Pse të zemërohet!

**PATER PJETRI** — Sepsë Toni ja u mëson shqipen me shkrolat latine dhe i bën kaurë.

**MRIKA** — (Qesh.) Edhe ti flet kështu, o Pâter Pjetri! Sá më vjen më qeshë.. Mehmet Ali Dreni është goxha djalë. Edhe të tjerët nuk janë të mitur. Para do javësh ishte këtu edhe Ismail Haxhi Tahiri.

**PATER PJETRI** — (Si me habi.) Qysh? Edhe qatipi i Haxhi Zekës vjen me nxanë shqip?

**MRIKA** — Ai vetë. Dhe i tha Tonit se shkrolat latine i shkojnë përshtati gjuhës shqipe. Kot rrekeni me e shkrua ndryshe.

**PATER PJETRI** — (Me habi të mëdhe.) Shiko, shiko!... (Ve sÿzët dhe i afrohet dërrasës së zëzë.) Ky kishte me qenë mësimi i ditës...

**MRIKA** — Është vjersha e Pashko Vasë Shkodranit.

**PATER PJETRI** — (Më mllef, por mënjanë.) Ai i patëhzonë! (Mrikës.) E di.

**MRIKA** — Këto ditë Toni ka marrë do libra dhe gazeta nga Italia.

**PATER PJETRI** — Unë ja mesova italishten, kurse ai i njofton italianët me të rejat e perandorisë. Si nuk m'i ka treguar mua!

**MRIKA** — Janë libra shqip. Kur ishte në Trieshtë herën e prasme u njoh me disa shqiptarë të ikur prej kohës së Skënderbeut, Njëri prej tyre: Jeronimi i Radhajve...

**PATER PJETRI** — Jeronim de Rada...

**MRIKA** — E kishte grishur në shtëpi të vet. Tashti i ka dërguar librat e veta shqip.

**PATER PJETRI** — Arbërisht.

**MRIKA** — Po, arbërisht. Kështu thotë edhe Toni, ata e quajnë veten arbëreshë. (Dëgjohet një zhur-

më.) Më fal, Atë Pjetri, duket se erdhën trimat. Po vete me iu thanë se po i pret. (Del.)  
**PATËR PJETRI** — Mein Gott<sup>1)</sup>! Qysh ta mbroj tufën e deleve të mia, kur qentë rojtarë miqësohen me ujquit grabitqarë!

### Dukja 3

Patër Pjetri, Prenkë Gulia, Toni i Prenkës.  
**PRENKË GULIA** — (*Hyn nga dera e jashtme.*) E kush të ka ndjekur nga mrizet buzë Drinit dhe të ka sjellë në shtëpinë time mes kësaj vase, o Patër Pjetri?

**PATËR PJETRI** — Urdhri i të fuqishmit, o Prenkë Gulia... A lihet qela ime e Zymit në këtë ditë të nxehjtë gushti? Nuk lihet. Por, kur të urdhëron Zhoti i dheut s'ke kah t'ja mbash. Do ta lesh atë kulm të qetë, ku ngazëlllohesh me tënëzonë dhe do të dirgjesh në këtë lug të potershëm për t'u ndeshur me sataninë: nga Sinaja do të shtegtosh në Babilonë... Abdulla pashë Dreni më çon fjalë e më fton: «Patër Pjetër, nisur e bjerë sa më parë në sarajet e mia, se kam një punë të ngutshme me ty». Dhe unë u nisa.

**PRENKË GULIA** — (*Me sherr.*) Paske hyrë në radhën e krerëve të vendit. Ata i ka ftuar në konakun e vët Abdulla pasha.

**PATËR PJETRI** — (*I përvutë.*) Ku ta dij unë, shërbëtori i perëndisë, se ç'radhë kam në defterin e të parit të vendit. Unë merrem me punët e zotit. Ju që merreni me punët e robit duhet t'i dini më mirë këto punë.

(1) Mein Gott (gjermanisht) = Zhoti im

**PRENKE GULLA** — (Njëlloj.) Me sâ mundemi. Ne  
reshperët nuk kemi hyrë ende në atë defter  
nderi. Kemi ngelur më poshtë, me krerëzit e  
polemit, më vegjelinin.

**PATER PJETRI** — (Disi qortues.) Dyqanin e kishe  
lënë në dorë të shërbëtorit, e pashë duke ar-  
dhur në shtëpi... që janë këto kuvende që të  
largojnë nga dyqani dhe shtëpia.

**PRENKE GULIA** — (I bën nder dhe e ul në një fron,  
ulet dhe vëtet.) Të qenkarrëfyer nusja e Tonit  
që në mëngjes... Nuk na len të qetë, Pater Pje-  
tri. Qe, njaj Maxhar Pasha, që ju ka grishur  
me gojën e Abdulla pashë Drenit, na ka shqe-  
tesuar këto ditë.

**PATER PJETRI** — (Këshillues.) Mjaft i keni shqetësi-  
met e tregtisë. Kë se kush kujdeset për të dër-  
guarin e mbretit. *Xhemijeti Ihtilati Islamija e*  
*Prizrenit* lidhë zgjidh grindjet e milletit me  
sulltanin. Ajo ka krerët vërt pašallarët, beg-  
lerët, agallarët. Ata vendosin e vulosin. Ti du-  
het të rrishi dorëjashtë!

**PRENKE GULIA** — Qysh mund të rri dorëjashtë,  
une jام myselim i të krishterëve, këshilltar i  
Lidhjes Shqiptare në Gjakovë. I dërguari i  
mbretit vjen për të prishur Lidhjen Shqiptare.

**PATER PJETRI** — Sultan Abdyl Hamiti dha ur-  
dhër që të rigrihet, ai mund të jepë urdhër që  
të prishet!

**TONI PRENKES** — (Duke hyrë.) Lidhjen Shqiptare  
e ngriti Komiteti i Stambollit. Abdyl e Sami  
Frashëri, Jani Vretoja, Paško Vasa, Zija Pri-  
shnai...

**PATER PJETRI** — (Murejtet në fytyrë.) Mirëmëngjesi, Ton!

**TONI I PRENKËS** — (I përbajtur.) Mirëmëngjesi!  
**PATËR PJETRI** — Kështu, o bir. Na përshëndet një-  
herë pastaj hyrë në kuvend. Unë kujtoja se  
vetëm yt atë është lanëtar i Pleqësisë së Gjako-  
vës.

**TONI I PRENKËS** — Edhe unë nuk jam ndonjë çun  
njomë, ndonëse nuk kam tagrin e pleqve.

**PATËR PJETRI** — (Duke i plotësuar mendimin e  
shprehur.) Dhe pleqtë nuk kanë tagrin e kre-  
rëye. Unë i thashë tyt eti që t'ja lemë këto te-  
lashe parisë.

**TONI I PRENKËS** — (Këmbëngulës.) Lidhja Shqip-  
tare nuk është vetëm paria, o Atë Pjetri.

**PATËR PJETRI** — Atëherë po të pyes, ty, o çuni i  
Prenkës, kush veç parisë merret me punët? E  
Itifakut të Prizrenit? Esnafët e qytetit? Resh-  
perët si Prenkë Gulia? Mehmurët si Ahmet  
Koronica? Kaçakët si Sulejman agë Vokshi?  
Krérezit e polemit? Kur u ka marrë dorën  
ndonjë herë mbreti e dovleti? Edhe miqtë tu-  
aj shkodranë u tërroqën përpëra valës islami-  
ke të pashallarëve, beglerëve, dhetëlemave...  
**PRENKË GULLIA** — Pashko Vasa i bindi vëtë të dër-  
guarit e Shkodrës që të lëshojnë pe, përndry-  
she Lidhja nuk mund të ngruhej. «Në fushën  
e Shkodrës Drini është i bashkuar, në Rraf-  
shin e Dukagjinit do të jetë edhe pak kohë i  
ndarë, por ne do ta bashkojmë!», — u tha.

**TONI I PRENKËS** — Ne do ta ngrehim Lidhjen  
Shqiptare edhe kundër Turqisë.

**PATËR PJETRI** — Si e qysh?

**TONI I PRENKËS** — Me dije dhe me hutë.

**PATËR PJETRI** — Sipas shembullit të Parisit, të Na-  
polit, të Venetikut?

**TONI I PRENKËS** — Sipas shembullit të Prizrenit, të Ramadanit të Zaskocëve, Mbarë Shqipëria do të ngrihet më këmbë. Dhe do të vijë.. erdhë dita e Arbërit!

**PATER PJETRI** — (Duke tundur kokën.) Unë besoj në mirekullitë e perëndisë, por nuk besoj në mirekullitë e njerezisë.

**TONI I PRENKËS** — Ti nuk bëson se Lidhja Shqiptare do të luftojë për më e mbrojtë Shqipërinë nga copëtimi, për më e cirua.

**PATER PJETRI** — (I patundur.) Jam porsi shén Tomaja: «Në mos pafsha në duart e atij shenjat e thumbave dhe të ve gishtin, tim në shenjat e thumbave, edhe të ve dorën në prindjet e atij, s'kam pér të besuar».

**PRENKË GULIA** — Ti, o patër, beson se vëtëm Fusqite e Medha...

**PATER PJETRI** — Turqia nuk e lejon një vilajet shqiptar autonom. Evropa nuk e pranon në gjirin e saj një shtet shqiptar mysliman.

**TONI I PRENKËS** — (I perngritur.) Shteti i Shqipërisë nuk do të ketë në themel të yet fenë, por kombësinë, ne nuk shikojmë kisha e xhamia, feja e shqiptarit asht shqiptaria. (Del nga kthina e mique me rrëmbim.)

**PATER PJETRI** — (Me habi.) O Prenkë Gulia, qyshkur nisi me udhakua<sup>1)</sup>, nëpër Evropë yt bir, Toni, ka marrë rrugën e largneshit.

**PRENKË GULIA** — (I qetë.) Është pak i rrëmbyeshëm, por nuk është i keq. Në të dy jemi të moshuar, prandaj năduken si të çuditshme, si

1) Udhakoj — frekuentoj

të pëرنgritura fjalët e rinisë. Pëرنgritja<sup>1)</sup> e tyre është e drejtë, ndonëse sajimet që ngrehin mund të na duken si ëndrra...

PATER PJETRI — (Qortues.) Nga përgatitja te kryengritja rruga është e shkurtër. Dhe kryengritjet, kudo që kanë shpërthyer, kanë qenë shikatërrimtarë... Unë erdha enkas në shtëpinë tënë me marrë Tonin deri te Sarajét e Abdulla Drenit, por Toni yt paska të tjera punë...

PRENKE GULIA — (Shqetësohet.) Mös kërkoni me të tërhekë në krahun e vet Maxhar Pasha?

PATER PJETRI — Unë nuk kam calina për brezi as hutë mbi sup...

PRENKE GULIA — Por besnikët e tu kanë huta e calina...

PATER PJETRI — Priftin e thërrasin për pajtësë e bashkim. Unë jam i bindur se pasia ime do ta qetësojë Mareshal Detruan. Unë do t'i flas gjermanisht. Është gjuha e fëminisë së tij. Fëminia është një párajsë e humbur në moshën tonë. Ajo na ngashëren sa herë e ndërmendojmë. (Ngrihet të shkojë.)

PRENKE GULIA — Edhe unë shkoj me shpresë se Maxhar Pasha do të na dëgjojë, Abdulla Dreni do të na bëhet krah, si kryetar që e kemi; por Sul Vokshi e Met Koronica, Toni im nuk kanë asnjë shpresë.

PATER PJETRI — (Dukë u nisur drejt derës.) Toni yt...

PRENKE GULIA — (E mban për krahu Pjetrin.) Prit, o Pater Pjetri! (Niset kah ana tjetër.) Ton,

1). Pëرنgritja — revolta.

o Ton, eja këtu! (Hyn Toni i Prenkës.) Do ta përcjellësh Pater Pjetrin deri në sarajet. Dhe mos u rrëmbej kështu. Ti... të nxehesh me Pater Pjetrin!

**TONI I PRENKËS** — (I trazuar.) Jam pezmatuar këq shumë pas mbledhjes së madhë në Terzihanë... Që ai Maxhar Pasha ka ardhur si një gjarpër i zi, që sjell dasi në kryen e Lidhjes Shqiptare, në trupin e kombit... Ne i thëmi murtat.

**PATER PJETRI** — (Me buzëqeshje.) Është një fjalë që ka marrë dhënë Maxhar Pasha është kryqali dhe ka qisht më kralité e Evropës, ai është murtat i fesë myslimanë. Me këtë parullë janë ngritur fanatikët kundër të dërguarit të mbretit.

**TONI I PRENKËS** — Lidhja Shqiptare nuk duhet të shpalosë një flamur të gjelber islamik kundër Maxhar Pashës.

**PRENKË GULLA** — Kush të kupton, mor bir!

**TONI I PRENKËS** — Por kështu jemi në rrezik të vritemi midis nesh për din e për fe.

**PATER PJETRI** — (Ngredurat, dhe lutet.) Zotynë pastë mëshirë, përmes Pater moster, qui es in coelis, sanctifiat nomen tuum. (I hedh një sy Tonit, Prenkës, i pari nuk falet, i dyti po.) Adveniat regnum tuum... (Vazhdon të mërmëritë deri në mbarim, të lutjes, pastaj i drejtohet Tonit.) Ti nuk falem më, o Ton!

**TONI I PRENKËS** — Përse? Nuk e ndjej iveten mëkatari?

**PATER PJETRI** — (I skandalizuar.) Vade rétro! Vade rétro... Ti duhet të bijesh më gjunjë e të falem... Qdo punë do ta fillosh me lutjen: «Në

emër të atit, të birit e të shpirtit të shenjtë...».

**TONI I PRENKËS** — Të them të drejtën mendjen e kam te trinia e shenjtë e shqiptarisë: Abdyl Toska, Gjon Vreta, Pashko Vasa.

**PATER PJETRI** — E shoh se ata të patënzonë janë idhujt e tu.

**TONI I PRENKËS** — Ata janë etërit, vellezërit që na tumbarin në rrugën e dritës kah liria e Shqipërisë. Ata na këshillojnë të mbjellim farën e shqiptarisë, të bashkojmë rrëmetin e përcarë nga fetë në një komb të vetëm sot, në një shtet të vetëm nesër. E dijmë se kjo punë është tepër e vështirë. Sapo kemi filluar me ndezë nga një dritëzë të vogël në mes të errësirës. (*I afrohet Pater Pjetrit.*) Unë e ngrita një mësonjëtore të vogël në Gjakovë, ti, o Pater Pjetri, mund ta ngjesh më të madhe në Zym...

**PATER PJETRI** — Qeveria e Stambollit nuk i lejon shkollat shqipe.

**PRENKE GULIA** — Në Prizren e në Gjakovë hyqmet e dovet eshtë Lidhja Shqiptare, tha Met Köronica.

**PATER PJETRI** — (*I përvutë.*) Unë s'ë kam moshën guximit, kam moshën e përvojës dhe të arsyetimit. (*Ngre sytë përpjetë dhe bashkon pellëmbët si lutës.*) Kjo barrë ëi dheut eshtë shumë e rëndë për supat e mij, o ilumi i qieillit. Unë nuk jam si Danieli, si Jezeqeli, si ata barinjtë e fiseve të Izraelit.

**TONI I PRENKËS** — Por mund të bëhen bari i besnikëve të tu; ashtu si Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, të cilëve u digjet zemra nga dëshira përtë ndritur të vobegtin dhe të Arbërit, se kështu, duke heshtur dhe

duke u bindur ke për të shtuar mjegullën dhe errësirën... (*Dëgjohet një lodër.*)

PATER PJETRI — Qé ku po bie lodrës tellalli hyqqymetit. Duhet tē ketë ardhë ndonjë lajm i rinya dovleti.

(Lodra pushon. Dëgjohet kënga e majekrahut:) 

«Nis Prizreni një fjalë për tel:  
Heu Gjakovë, gou e dek;  
Se të ka ardhë një mik me sherr!

(Bie ngadalë sipari, derisa rifillon të dëgjohet lodra e parë e pas saj edhe të tjera.)

## VEPRIMI III

A. Pâmja nga rruga.

Sheqerxhihana e Sili Bozaxhiut.

Dukja 1

Hoxhë Qitapi, Bozaxhiu,

HOXHË QITAPI — (Hyn me një qitap nën sqetull.)  
Bakllava ka?

BOZAXHIU — (Nga dritarja e qoshkut.) Ka.

HOXHË QITAPI — Hallvasi ka.

BOZAXHIU — Sherbet, dondurma, bujrum, mulla  
Shemshedin Karaosmani.

HOXHË QITAPI — Shemshedin Karaosmanoglu  
Kurshumlia. (Ulet në karrike.) Vasil Bozaxhi,  
birinxhi sheqerxhi.

BOZAXHIU — (I sjell një pjatë myshteriu.) Ju ho-  
xhallarët i keni qejf shumë ëmbëlsirat.

HOXHË QITAPI — (Qesh.) Kush nuk i ka qejf! Pa-  
shallarët, beglerët kanë qejf bakllava, hallva-  
si. (Ha me dorë.)

BOZAXHIU — Edhe myftilerët, ylementë...

HOXHË QITAPI — Evet, evet! (I bën me shenjë t'i  
sjellë pjatën tjetër. Bozaxhiu ja vendos për-  
para.)

**BOZAXHIU** — Pse gatuajnë hallvë pér vdekje, mulla Shemshedin?

**HOXHË QITAPI** — Njeriu kure ha mirë, mendon mirë. Thotë pér të vdekurin: «rahmet xhan!».

**BOZAXHIU** — Njeriu duhet të mendojë mirë pér të gjallët, se i vdekuri shkon me të vdekurit, dhe mendja jone, e mirë a e ligë goftë, as i prish as i ndreq punë. Unë dua të dij: a mendon mirë pér ne të gjallët Maxhar Pasha që ha bakllava, hallvasi.

**HOXHË QITAPI** — Pasha Mehmet Ali, bashi pasha, hazretleni!

**BOZAXHIU** — Nuk ju marr vesh juve hoxhallarë - ve; kadiu i Gjakovës, hoxhë Met Koronica thotë se Mehmet Ali pasha, eshtë murtat; mulla Shemshedin Kurshumlia thotë se pasha Mehmet Ali, eshtë hazretleri.

**HOXHË QITAPI** — (Ve dorën mbi qitap.) Unë jam hoxhë me qitap.

**BOZAXHIU** — E di, prandaj të pyes dhe unë. Ti duhet t'i dish mirë këto punë, nuk të thonë kot Hoxhë Qitapi.

**HOXHË QITAPI** — Milet i Arnautllukut merr vesh jangëllisht punët e allahut, dhe padishahut, sert milet. Kadiu i Gjakovës merr vesh keq qitapin. Murtat eshtë dushmani i hazret Muhametit, tradhtar i mbretit. Kur myslimanit traditon dinin e vet duhen dy shahitë.

**BOZAXHIU** — Për shahitë kadiu ynë ka të gjithë milletin e Prizrenit, Gjakovës.

**HOXHË QITAPI** — Jallan kadi, jallan shabit. Pa shën Mehmet Ali nuk e gjykon kadiu i kaza Gjakovës as kadiu i vilajet Kosovës, atë e gjykon kalifi jetë, padisha sultani Abdyl Ha-

miti. Pasha Mehmet Ali tyrk osmahilli me din  
e me iman... Sherbet!

**BOZAXHIU** — (Me dorë në zemër.) Peqe, mulla efendi sherbet. (I-sjell gotën e sherbetit.) Të kishe qenë pardje në sheqerxhihanën time, mulla Shemshedin. Një gjyrylldi e madhe që s'e merrte vesh qeni të zone. Milet i Gjakovës nuk i njeh drejt punët e padishahut, pa qitap... E po ca theshin sé Maxhar Pasha është kaur, ca turk, ca kryqali e mynafik, ca i mirë, ca i lik. «Që të dalë në shesh e vërteta duhet bërë okllama. Është bërë a nuk është bërë synet,» tha njëri. (Hoxhë Qitapi i e shikon vëngër, nxjerr paret të paguajë.) «Synet është bërë më siguri, tha tjetri, por këtu e një javë më parë.» «Po të ishte bërë synet para një jave, duhej të ishte veshur më dolloma, pa brekë.»  
**HOXHE QITAPI** — (Me inat!) Shejtan sheqerxhi, gojëzeher. Pis milet.

**BOZAXHIU** — E po Gjakova e téré e pa hypur më kalë.

**HOXHE QITAPI** — Gjakova kazasti, dhllanën belasi<sup>1</sup>). (Niset të dalë.)

**BOZAXHIU** — (E ndjek duke qeshur.) Ha, tha, ha! (Po po) Gjakova kazasi sultanën belasi.<sup>2</sup>)

### C. Pamja nga sarajet e Abdulla Drénit.

Konaku i miqve me nga një derë në secilin krah, një divan në mes, pas tij shkallët që

(1) Qyteti i Gjakovës belaja e allahut  
(2) Qyteti i Gjakovës belaja e Sulttanit

Ujgjiten në katin e sëpërm, dritare e frëngji në krahun e djothë, orendi dhe stoli orientale të qytetit këshës varur në mure ashtu dhë të shtruara për trollin.

Sa cierhuni s' nisneni mësi... — **ABDULLA DRENI** —  
**Dukja!** —  
S' nisneni s' nisneni.

**MAXHAR PASHA, Abdulla Dreni, Adjutanti i sultani Sulltanit zëresin nga shkallët, sipas radhës.** — I  
I nuk fitreti mban vë të dorë fermanin e sultani.

**MAXHAR PASHA** — Abdulla pashë Dreni, sipas kësaj kohës nuk fitreti të t'parëve dhe t'vendit kam ardhur në konakun tënd si mik.

**ABDULLA DRENI** — (Me dorë në zemër.) — Mirë se shqiptarëtë ka prurë zoti, Mehmet Ali pashë! — **MAXHAR PASHA** — Tu e di mirë se këtë frugë për në vilajetin tuaj e mora me urdhër të padishash s'edhe, sultani Abdyl Hamitit.

**ADJUTANTI I SULTANIT** — Allahu ja shtoftë ymirin.

**ABDULLA DRENI** — Amin. — **MAXHAR PASHA** — Eshtë detyrë e vështirë të bindet ky millet, e di. Por, me shpresë të allahut: ashtu si bindëm kërët e Itifakut të Prizrenit, do, t'i bindim edhe kërët e Itifakut të Gjakovës.

**ADJUTANTI I SULTANIT** — Inshallah!

**ABDULLA DRENI** — Në Gjakovë do të jetë pak vësh-tirë, sepse pëga e Itifakut ka në krye mjaft pri-jesa të milletit, njëzet të pagdhendur, të zbritur nga malësia...

**MAXHAR PASHA** — (Rëndë.) Në Gjakovë ti je i pa-sobriti i vendit, kryetar i Itifakut, me taraf në fu-

shë e në malësi. Krerët: beglerët, agallarët, bajraktarët do të marrin krahun tënd.

**ABDULLA DRENI** — (I sigurtë.) Ashtu më duket dhe mua.

**MAXHAR PASHA** — (Merr fermanin e sulttanit në dorë.) Në qoftë se do të zbatojmë fermanin e sulttanit, Porta e Lartë nuk do ta harrojë këtë ndër... (Abdulla Dreni puth fermanin e sulttanit.) Aferim! Mos u kurse ashtu si nuk do të kurse hem unë për ty. (Maxhar Pasha i dorëzon fermanin Adjutantit.) Të premtova se Bajram Agën do ta bëj bimbash në ushtrinë e padishahut.

**ABDULLA DRENI** — E kam në sarajet e mia.

**MAXHAR PASHA** — Shaqir agën e kishe me vete në Prizren. E ke këtu?

**ABDULLA DRENI** — Si urdhëron.

**MAXHAR PASHA** — Do ti kesh thirrur edhe miqtë e tu katblikë, krerët fandë edhe Pater Pjetrin?

**ABDULLA DRENI** — I kam thirrur.

**MAXHAR PASHA** — Atëherë nuk na mbetet vetem se qyteti me katundet përreth. Ata i ke më afër...

**ABDULLA DRENI** — Disa i kam në konak.

**MAXHAR PASHA** — (Fërkon duart.) Hëi... Dëgjo-va se Ali Pashë Gucia ndodhet në Gjakovë. Ai burri nuk ështe në vete.... Më thanë se rreket nje mbledhë vuillnetarë për në kufi. (Shfrym me zemërim.) I pafytyrë!

**ABDULLA DRENI** — E kam ftuar edhe atë. Nuk besoj se do të mungojë.

**MAXHAR PASHA** — (I kënaqur.) Aferim! Po të kemi shumicën e krerëve, mileti do të bindet.

**ABDULLA DRENI** — Në konak kanë ardhur edhe  
krerët e miletit: Sulejman Agë Vokshi... Ti e  
**MAXHAR PASHA** — (Rohon me kokë.) Atij i kam  
bërë një ndet të madh.

**ABDULLA DRENI** — Me të është kadiu i Gjakovës,  
**MAXHAR PASHA** — Ahmet Koronica dhe një reshper: myselim i të  
krishterëve, Prenkë Gulia... Unë nuk t'ë jap  
këshilla, o mikujim, por nuk do të prishte pu-  
në sikur ta nisnim këtë muhabet shtruar dhe  
me të butë.

**MAXHAR PASHA** — Unë ashtu do ta nis... Por du-  
het të dish se mili bindet me të keq e jo me  
të butë. Kush ngrë krye kundër vullnetit të  
padishahut, të lidhet, të gjykohet, të dënohet.

**ADJUTANTI I SULTANIT** — Evet, Mehmet Ali  
Pasha! Në Prizren dushmanët e dovetit na  
vranë telegrafistin.

**ABDULLA DRENI** — Ishte punë me hata.

**MAXHAR PASHA** — (Hakmarrës.) Atje e bëmë kur-  
banim e parë ne, këtu ka kanë radhën ata.

**ABDULLA DRENI** — Eshtë e ürtë t'i ruhem gjak-  
derdhjes.

**MAXHAR PASHA** — (Disi, më i shtruar, por me di-  
nakëri.) Edhe unë dua t'i ruhem gjakderdhjes,  
miku im, por ndonjë dushman kaktengjeshur  
do ta lidhim... Pa i hap sytë mirë edhe ti e më  
thuaj: g'ishte ajo rrëmujë e bujshme, pardje  
në Prizren dhe kjo qetësi e ftohtë sot në mën-  
gjes, kur hymë në Gjakovë? (Profetik.) Filli-  
mi i kryengritjes.

**ADJUTANTI I SULTANIT** — Ata na vranë një, në  
duhet t'u vrashim dhjetë, njëzet!

**ABDULLA DRENI** — Eshtë punë me zarar, o adjutanti i sultantit.

**MAXHAR PASHA** — Vetëm kështu do të zënë punët e vilajetit një karari (i vendosur dhe mospërfillës). Ti mos u t'emb, Abdulla pashë Dreni.

Nuk kemi përpara. Tunën e turbullt, ujëshumë, nuk i mpor. Përroli e kthilluar, ujëpak. Nuk kemi përgatitur para mizérinë e Moskovit të armatosur deri më sot. Dhëmbë, por një tufë me malësorë zhelanë armatosur më do karajfile të vjetra; që mbushen nga gryka... (Me mëri.) Këta njërez na pengojnë të shpijnë vend urdhërin e pâdishahtit, ai hut, po n'a koritini në sytë e Evropës. Le të urdhërojnë miqtë e ful! (Shkon e ulet në divan, dherpas i qëndron më këmbë Adjutanti, Abdulla Dreni përplas duart tri herë.)

**Dukja 2**

Maxhar Pasha, Adjutanti-i Sultantit, Abdulla Dreni, Ali Gucia, Bajram Aga, Hasan Batusha, Shaqir Aga, Sejmeni i Abdulla Drenit, Sule Vokshi, Met Koronica, Prenkë Gulia.

**SEJMENI I ABDULLA DRENIT** — (Hyn nga dera e mësuar jathtë.) Urdhëroni, Ali Pashë Gucia! (Hyn nga i Ali Gucia.)

**MAXHAR PASHA** — Hoshgjeldën,<sup>1)</sup> Ali pashë Gucia.

1) Hoshgjeldën — mirë se vjen/zaferi i vinte.

**ALI GUCIA** — (Shkon e përshëndetet me; mikun.) Mirë se na keni ardhë Mehmet Ali pashë.

**ABDULLA DRENI** — (Të tjerëve që hyjnë, nga e majta.) Urdhéroni, miq!

**MAXHAR PASHA** — (Me dorë në zemër.) Mirë se vini! Hoshgjeldën, hoshgjeldën beglerë, agallarë, krerë të parisë dhe krerë të miletit.

**ABDULLA DRENI** — Urdhéroni e zeni vend, o bu-rrat (U tregon mique karrigjet për t'u ulur. Dhe Kata ulen me radhë.)

**ABDULLA DRENI** — Mehmet Ali pashë miku ynë, u-gëzua fort, kur mori vesh se deshët me e përshëndetë. Ai ka qejf me ju thanë dy fjalë para se të ngjitet në konak të jet për t'u shplo-dhur.

**MAXHAR PASHA** — Pashallarë, beglerë, krerë të parisë dhe të miletit, miq të mbretit dhe të do-vletit, babambret ju bën selam, që nga Stambollit Qofshimi me shëndet e me kuvet, trimi si keni qenë përherë në Perandorinë Osmane. Padisha Abdyl Ha-siti emiti ju mban si hajmali në sqetull. Ju e di se jani se babambret ka rënë ngushtë me Evropën.

Por me gjithë këto të zeza, babambretit iu bë qejfi shumë, kur mori vesh se paria e Aronaut llukut nisi me lëvizë, me lidhë besën përmbrojtjen e frojeve tonas. «Hej, shyqyr i qoftë allahut, që u ngritën këta trima për t'u bërë ballë knjazëve të carit». U lejoj të ngrini Itifakun në Prizren. Sulltani ju dha dorën si baba i vërtetë.

**ALI GUCIA** — (Më dorë në zemër.) I qofshim falë, ashtu ka qenë përmjimënd. Ne e ngritëm Itifakun në Prizren nga e keqja dhe shtrëngesa.

Plava e Gucia, Kelmendi, Hoti e Gruda, Malësia e Rrafshi i Dukagjinit, Kosova, mbarë Shqipëria e ndjeu menjëheri rrezikun e madh. Ne i pamë me sy muhaxhirët e Tivarit, Shpuzës, Vranjës, Leskovcit, që shtrin duart përmësimi shë përparë dyerë tonë. Atëherë u mbledhën në Prizren dhe thamë njëzëri: «O burra, të bashkohemi, të lidhim besën që të shpejtjmë vatanin!» Babambret vuri dorën në zemër dhe na u bë krah. E kishim hak... Ne jemi bëre fli dëmbabadem përmbrerëtinë. Qëmë të parët që morën fenë e Muhametit, fenë e fitimitarëve osmanllinj. «Ku është kordha, atje dhe feja», thanë krerët. Dhe ashtu u bë. Pashallarët, beglerët tanë gjetën te sultani një zot, i cili u hapi fushën e ngadhnjimit, të lavdisë, të pasurimit. Sulltanët osmanllinj gjetën te paria jonë shokët kordhëtarë dhe besnikë. Kështu i dha Shqipëriá Perandorisë Osmane njëzetepesë sadrazemë nga më të dëgjuarit dhe luftëtarë të panumurt... Katërqind vjet këmi shkuar mirë, jemi kuptuar njeri me tjetrin; vetëm katërdhjetë vjetët e fundit nuk po kuptohemi dot.

**MAJHAR PASHA** — Nuk po kuptohemi se ju kanë fryrë rië vesh të pëaudhët e Komitetit të Stambollit: Abdyl Frashëri, Jani Vreta, Pashko Vasë Shkodrani, Hoxhë Hasan Tahsini, Zija Prishtina që të tjerë shejtanë, që hanë bukën e turkut dhe bëjnë duvanë e kaurit. Disa prej tyre erdhën deri në Prizren e në Gjakovë dhe jau ngritën mendjen me u shkëputë nga Perandoria Osmane...

**ALI GUCIA** — Ne nuk duam tē ndahemini nga Turqia, Arie kërkohmë tē mblidhemi në një vilajet që tē mbrojmë Shqipërinë. Aku s' përdosi

**SHAQIR AGA** — Ali pashë Guçia ka hak

**MAXHAR PASHA** — (I zemëruar) Ali pashë Guçia -sq i nuk ka hak. Ai flet në kllapi: si ka shqiptarë e ja, ut's ka Shqipëri q Themeli i Perandorisë Osmane është feja e Muhametit. Ne jemi muhamedianë, i lloj turq osmanlinj. Në qielvinjë aljah perëndi, në dhë një kalif, mëkembësi i tij. Ne jemi të gjithë ushtarë tē bindur tē Perandorisë. Edhe ti,

Ali pashë Guçia, si ushtarë duhet t'i bindesh fermanit të sultantit. Aku u — **ABDULLA DRENI** — **ALI GUCIA** — Qysh, bre Mehmet Ali pashë? Të lë-shqipshoj planq e shtëpi në dorë tē armikut dhe fëmijët e tij. Sa tē jemi gjallë jo. Unë nuk e obni kâm prerë shpresën prej padishahut. Atij do t'i shkruaj një letër, ku t'ja qaj hallim!

**SHAQIR AGA** — (Me habiti) Unë nuk kuptoj, bre bùsqë i Arrashka i prishin mbretërisë shqiptarët, po tē bashkohen në një vilajet. Ti, Abdulla pashë un i Drenit më këthënë se vilajeti i Shqipërisë mund tē nxjerë dyqind tabore ushtarë. Eshtë apo nuk është kështu?

**ABDULLA DRENI** — Kështu është, o! Shaqir Agë!

**SHAQIR AGA** — E po me dyqind tabore ushtarë bllojet qëndret dreqi pale kniazët e Malit tē Zvëdhë tē Kurit i Sérbit. Am i t'si Mëmiasbyt që erih icolai

**MAXHAR PASHA** — Po s'kurr edhe muhamedianët e është vostjerë tē Perandorisë arabë, kurde, çerkezë,... sa imi tē ngrihni nga një vilajet me vete ashtu si e do-ën Abdyli Frashëri? Turqia do tē bëhej copa-copët. Jep Ali pashë Guçia dhe disa krrerë tē tjere, nuk i shohin, nuk i njoftin tē mirat që u

ka sjellës Perandoria Osmane? E ku mund të  
njohni hej kaq lart fisnikëria juaj? Në Arnautlluk  
kishte a nuk kishte vend për një a dy pasha-  
llarë, për një a dy teste me beglerë... Arnautlluk  
ku është tepen i vogël për kaqë shumë burra  
të mëdhenj. Ju duhet të krenohen se keni pa-  
sur në dorën fatin e një perandorie. Ashtu, si  
tha vete Ali pashë Gucia e keni bërë fli veten  
për Turqinë. Edhe sot është detyra juaj që t'i  
bëni kurban trojet e ngushta të Plavës e Guci-  
së për të shpëtuar trojet e gjera të Perandori-  
së. Ju na keni dhënë fjalën? Sëasq iu.

**ALI GUCIA** — Ju nuk jeni për imbrojtjen e Gucisë  
dhe të Plavës? Sëasq iu. MAXHAR PASHA — (Parasnjë ndryshim.) «Shqiptarët  
e sun ri kurr jep fjalën, thar djalën». Edhe ti, Ali Pa-  
sha, do ta bësh kurban shtëpinë për Perando-  
rinë.

**SULE VOKSHI** (Shtruan) Sa bukur që i njeh do-  
sq joket e zakonit e shqiptarëve, o Mehmet Ali pa-  
rasq shëndas! Të zbuliv qje të ardhur!  
**MAXHAR PASHA** — Kot nukimë, ka dalë nami në  
Portënie Lartë si mikë dhe dashamiri i arna-  
utëve. Nderi lyp nderi!

**SULE VOKSHI** — Por edhe besa, besë! MAXHAR PASHA — Domosdo. (Por ju na lypni besën që vetë të  
jetoni dhe ne të vdesim. Mjaft më. Kështu nuk  
mund të mbajmë miqësinë. Dje na bëte kurban  
në Shën Stefan, një copë të Shqipërisë, sot në  
Berlin kërkua t'ju copë tjetë. Por a e dini se  
këto troje janë dheu ynë; këta njerëz, që en-  
dot dëshirët nëpërrugatë mbretërisë, janë gjak nga  
ngjaku ynë? jo! I shumë mështri i dini. Por

**MAXHAR PASHA** — Ju nuk e kuptoni se në krahasim me Shën Stefanin, Berlini ishte për ne drekë bajrami.

**MET KORONICA** — (*I papërmëbajtur.*) Për ju ishte drekë bajrami se i shtruat Shqipérinë princëve të Ballkanit, ... kurse për ne ditet e Kuvenit të Berlinit ishin ditë zëndani, jo ditë bajrami. (*Me tjetër ton.*) Ne e kuptojmë farrë mirë se këshfu si i keni një pazarllëqet me Evropën, dë t'na e shisni tërë Shqipérinë, prandaj kemi vendosur të mos e lëshojmë Plavën e Gucinë,

**MAXHAR PASHA** — (*Me ngjilm.*) Dë ta lëshoni! Për këtë punë kam ardhur deri këtu:

**MET KORONICA** — (*Pa u tundur.*) Pashë hazretleri, jo ti, por sikur të vijë edhe vetë sultani, ne nuk do ta lëshojmë vafanin. E kemi trashëgim nga të parët tanë.

**MAXHAR PASHA** — (*Me rendesi.*) Kadi efendi, këshfu si flet ti, po më detyron me të nisë duar lidhur në Stamboll.

**MET KORONICA** — Kij mendjen se mos të dërgoj- më ne ty.

**MAXHAR PASHA** — (*Shpërthen.*) Unë kam ferma- një sulltanit.

**MET KORONICA** — (*Me shtruan.*) Edheunë kam një letër nga dora e tij, ku më këhillon bëhem krah-Itifakut. Nuk e besoj që kalifi të ketë lu- jutur nga afjala. (*Medinakëri.*) Druaj! Se ti ke gishtë më krajillitë e Evropës, ashtu si silitet po- shëtë e përpjete.

**MAXHAR PASHA** — (*Nuk e përbani vëten.*) Kadiu Gjakovës ka dalë mendsh. Ju të tjerët veni

gishtin kokës Ti Ali pashë Gucia i pari, shpërndaji trimat.

**ALI GUCIA** — (*Duke nixjerré dörën pérpara.*) Mehmet Ali pashë, mik të kam dhe të pderoj, po këtë fjale nuk ta dëgjoj.

**MAXHAR PASHA** — (*U shtrin duart të tjerëve.*) Pashallarë, beglerë, agallarë, jeni a nuk jeni me dovletin!

**HASAN BATUŠHA** — Ne më dovletin jemi, por nuk kemi gjë në dore. Thirr në kuvend Rrafshin e Malessine.

**SULE VOKSHI** — (*Duke treguar me dorë veten e vet, Met Koronicën, dhe Prenkë Guline.*) Ne krejtë e miletit të Gjakovës, jemi të dërguarit e Rrafshit, dhe të Malessisë. (*Heshtje.*) Ne e kemi marre yesh prej kohësh se Mbretëria e Stambollit nuk është në gjendje t'u dalë përvot trojeve tona, prandaj e lidhëm besën në Prizren, që t'i dalim zot vatanit vete. (*Heshtje e shkurtër.*) Ali pashë Gucia ju tha se ne pas kemi katërdhjetë vjet, dë nuk mëremi vesh me Stambolin. Ndoshta kreuët e parisë, pashallarë e beglere mund të kenë katërdhjetë vjet që po grinden dhe ndeshen me Stambolin, sepse atyre lëshiti u hasi thika në rrash. Por milieti i Shqipërisë ka plot katërgjind vjet, që vuani nën zgjedhë. Ngre krye, bie dhë ngre krye përsëri në luftë me Stambolin, qysh kur ra Kruja e Skënderbegut në një bërtor të zi... (*Heshtje.*) Pas katërgjind vjetësh, në qershori, që tanga hiri e shpuza e kësaj luftë tërgjatë, ne e ndezëm në Prizren një zjarr të ri, e lidhëm besën shqiptare. Nga kjo besë e madhe do të rinde mëmëdheu ynë, Shqipëria. Ne kemi be-

sim e shprësë edhe pse ti na thua se s'ka shqiptarë e s'ka Shqipëri.

**MAXHAR PASHA** — A e dëgjoni, o krerë të parë? Këto janë fjalët e të paudhëve të Stambollit, që ju thashë më parë, janë fjalët e Abdyl Frashërit.

**SULE VOKSHI** — Fjalët e Abdyl beg Toskës janë fjalët toha. Ai na tha një natë në këtë konak se Mbretëria Osmane ka marrë tafjetet. Ajo s'është e zonja me mbrojtë trojet turke, pale trojet shqiptare. Të vjen a s'të vjen mirë, o Maxhar Pashë, kjo është e vërtetë.

**MAXHAR PASHA** — (*Me mëritur.*) Qysh qenka e vërtetë, or kaçaku i malit! Haj, si po ma shperblën të miren me të keqe... Më këshillën e këtij Abdulla pashe Drenit, unë i kam rënë në gjuhje sultantit për të marrë ferma-nin që të të falte jetën.

**SULE VOKSHI** — Dhe unë erdha më ushtrinë e mbretit deri në Tuhe të luftoj me Moskovin: ndër pér ndër. Por ti në Kuvendin e Berlinit na preve në besë, na shite te privatcat e Ballkanit.

**PRENKE GULLA** — (*Me këgjardhje.*) Medet, o Marshall Detrua, si nuk e the një fiale të mirë pér Shqipërinë.

**MAXHAR PASHA** — (*Me përbuzje.*) Edhe ti, myslim i kâtreve, guxon të më qortosh. Ti strehon dyshmanët e mynafiket e doblezit. Ti hap shkolla pa lejen e hyqymetit.

**PRENKE GULLA** — Në Gjakovë hydymet është Lidhja Shqiptare, që më shkolla mbiell farën e bashkimit në vilajetin e Shqipërisë. Ne jemi shqiptarë, pastaj myslimanë e të krishterë.

Ty mund të të duket çudi se qysh e kemi rujtjë një kombësi në katërqind vjet. Ke të drejtë se ajo fara jote në njëqind vjet ka ndërruar tri lëkurë: ishit frëngj së pari, së dyti gjermanë e së terti jeni otomanë.  
**MAXHAR PASHA** — (I tèrbuar.) Ju duheni lidhur që të gjithë, sepse keni ngritur krye kundër pushtetit të madhërisë së tij, sulltan Abdyl Hamitit.

**SULE VOKSHI** — (I përmbarjtur.) Në i dëgjuam të falat që na dërgoi mbreti. Dëgjo tashti edhe të falat tonë që tia kthesh kur të mbërrish në Stamboll: «E kemi marrë vesh së Krajlitë e Médha në Berlin kanë thënë se s'ka Shqipëri e s'ka shqiptarë dheti nuk na ke dalë zot si mbret që të kemi. Na ke lëshuar ne duart e ktheftat e fqinjëve lakmitarë... Prandaj po të çojmë fjale së nuk jemi miqtë e tu. Që këtej e tutje do të përpinqemi ta mbrojmë anekënd dheun e të parëve me duart tonë. Dhe Evropa ta marrë vesh se ka Shqipëri, se ka shqiptarë».

**MAXHAR PASHA** — Unë nuk kthehem në Stamboll pa kryer detyrën.

**MET KORONICA** — Në qofsh trim, kapërxë Pérroin, pa ta shohesh...

**SULE VOKSHI** — Me ty e myllém Akyverdin, o i dërguari i mbretit. Kemi dy fjale vetëm me të zotin e shtepisë.

**ABDULLA DRENI** — Urdhëroni.

**SULE VOKSHI** — (Shtruar.) Milet i Gjakovës dhe i katundeve perreth është shqetësuar shumë, e përci që dëkur pa Mehmet Ali Pashë Maxharin me një imjet e tabor ushtarë, kah po zen vend në shtëpinë

tënde. Mbledhja e parisë dhet vegjëlisë në shtëpinë e esnafëve, duke shansur si dërgatë të Lidhjes Shqiptare, na tha me të porositë që këtë mik, të cilinë këmarrë në ndore,<sup>1)</sup> ta nxjerrësh nga shtëpia dhe nga qyteti ynë.

**ABDULLA DRENI** — (*Po ashtu shtruar.*) Ti e di mi-  
rë, Sulejman agë Vokshi, se mik u nuk i pre-  
ket të zottutë shtëpisë. Të më lypë shka të  
dojë sileti i Gjakovës, mall e gjë, troje e  
shtëpi ja fali, ndër e shpirti mik ështëgtar,  
nuk ja fali. Nuk e pres mikun, në besë.

**METË KORONICA** — (*Me zemërim.*) Maxhar Pasha  
i përditë ka ardhur vërfet ai mik i shtëpisë, por  
ai është armiku i Shqipërisë. Kuvendi i po-  
dëmit, nuk e përcënët e përbigjet.

**ABDULLA DRENI** — (*Interfjalen krenar.*) Polemit  
të Gjakovës, skëndë se shkak duhet kush hyn e  
kush del, në shtëpinë tímë. Mehmet Ali Pa-  
shë unë e kam mik.

**SULE VOKSHI** — Armiku i Vendit. Nuk mëjhet mik  
për askëndin. Qyshkur e fute në shtëpi këtë  
armik, ti na prëve në besë, të gjithë në.

**PRENKE GULIA** — (*Ndërhyn në mes të heshtjes  
me të butë.*) Abdulla pashe Drehi, Sulejman  
agë Vokshi ka të drejtë. E lidhem a s'e lidhëm  
besën shqiptare në Prizren mos me lëshua as-  
një pellumbë tokë nga trojet tonë?... Ne nuk  
duam që ti të dalësh mikpremë, prandaj për-  
cille mikun. Të kthehet nga ka ardhur.

**METË KORONICA** — (*I papërmabajtur.*) Të shkojmë,  
Sule Vokshi. Dhe, ti, o Prenke Gulia, kota

1) Ndore — besë, lësh, që varet nga një përfundim i çfarë.

“Lejla mundohesh me fjalë të buta, këtu duhet të  
shëgjeb këreasë huta e bëjës së vajzave  
shëzonca si u shkruan qëndri i tij si  
(Gjithashtu është Dalmatian që dëshirat më rrëmbim.)

Dukja 3.11 (Të dytë e tretë e tij) — ISKETT ADJUTANT  
shqip i tij Maxhar Pasha, Adjutanti i Sulltanit, Ab-  
dullah Djeli, Ali Gucia, Bajram Aga, Ha-  
sani, Hasan Batuša, Shaqir Aga, Sejmëni.

MÄXHAR PASHA — (Vjen rrrotull nëpër konak, i  
zemëruan.) Të tillë njerëz i kokëshkretë, dhe  
një kryengritës i sjell në din vetëm pranga, dhe  
një sakusma, konopi e plumbi. Nuk ka fatkeqësi  
të, i thënë të madhe përfnjë vend se kryengritja e  
vegjelisë, e fundërisë... Në qoftë se ju kërret  
të nislojë parisë do të trini duarkryq, vegjelia me kren-  
të, myd, drëzit e saj të kësuar do t'ju sulmojë nëpër sa-  
kut. (Araje, këshilla,) ndonjë t'ju lë trëmbejë mall  
e gjë, pasuri ëm stoli dhe pastaj do  
t'ju shverë, hyzmegarë, të fshinj, grugët,  
të pastroni, gjirizët. Këshfu i ndodhi  
parisë së Parisit dy herë brenda njëqind  
vjetësh. Të parët e mij ishin frëngj, ashtu si  
dhe ai reshperi, por ishin fisnikë, sojlinj...  
Prandaj muarr arratinë. Unë që kam parë e  
njojur botën më tepër se ju e ndjej se ky fe-  
sat shkatërrimitar i miletit plasi edhe në Ru-  
meli, në vilajetin e Kosovës. (Dëgjohen lodrat  
e kushtrimit që jashtë.)

SEJMENT — (I skandalizuar.) Stafkurullah!  
SHAQIR AGA — Unë nuk dij se shka mund t'i kë-  
të heddhur Evropës, o miku i Abdulla Dre-

1) Këshilla — ndërtesa të mëdha, gazerma. 92 d — orohV (1)

nit; por di të them se pas ratyre k'fjalëve që  
shkëmbyem, do të kërcasë huta përnjimend;  
ashtu si tha Met Koronica. Duhej të kishim  
folur ndryshe.

**MAXHAR PASHA** — Mos duhej t'u bindeshim?

**SHAQIR AGA** — Unë them se duhej kuvenduar  
ndryshe; t'i lenim një shteg pajtësës dhe ma-  
rrëveshjes.

**ABDULLA DRENI** — S'kam se qysh të pajtohem me  
Sulë Vokshin dhe Met Koronicën.

**SHAQIR AGA** — Atëherë mbushni armët të luftoj-  
me!

**ADJUTANTI I SULTANIT** — Sarajet e Abdulla  
pashë Drenit janë të sigurta. Në kemi një ta-  
bor ushtare, armatosur me armët me të reja.

**SHAQIR AGA** — Djalosh, luftën nuk e bëjnë hutat  
e martirat, por kapetanët e trimat.

**MAXHAR PASHA** — (Shtruar.) Avash-avash, Nu-  
man bej... Shaqir aga deri diku ka të drejtë.  
Ne, sot, nuk jemi në gjendje për ti bërë ballë  
një sulmi. Kemi vetem gjashtëqind ushtare.

Tabori nga Mitrovica vjen nesër, ose pas nesër.  
Miqte e tu, Abdulla, janë të paket. Kemi ve-  
tëm krefet pa trimë. (Hedh një sylt rreth tij  
dhe bën disu hapë drejt Shaqir Agas, i cili  
nuk ja miraton mendimin që ka shprehur, po  
ashtu edhe drejt Hasan Batushës, ndërsa Baj-  
ram Aga i buzëqesh me dörë në zemër.)

**ABDULLA DRENI** — Edhe trimat do të vijnë.

**MAXHAR PASHA** — Aferim, bimbash Bajram Rus-  
sim tem. Aferim! (Njëzet kah Ali Gucia.) Ne s'kemi  
qen mesi e qyshi të pajtëhem me kretëzit e mëletit,  
por me kretëzit e pafisë nuk do të trimë të më-  
ritur. Fatkeqësia jote, o Ali pashë Gucia, do të

risë, dhe bëri gjëmën: *Le général Cluseret de la Comune de Paris!*... (Më shtruar, por me mëllaf përsëri.) Edhe atantë tjerët, po t'i gërmosh thellë, do t'i gjesh të ngatërruar me shumë të liq dhe amiq të dovletit. (Paditës.) Këta njerëz nuk duhen mbajtur në punë si mehmurë, këta duhen burgosur, duhen syrgjynosur. / (GJUJMË DRENI - DRINI ARISSA)

**ADJUTANTI I SULTANIT** — Eveti, Mehmet Ali imjet e Pasha! Shët (Bwësësi) — AHSAT (Bwësësi)  
**SHAQIR AGA** — Pashai Zotin, Mehmet Ali pashë, imjet i na e turbullave mendjent em.

**ABDULLA DRENI** — Mehmet Ali Pasha rrreket me një stërmale kthjellë mendjen e turbulluar, Shaqir i i lëndaga. Kërëzit e mëllëtë ritik duan as mbret, as shështë parët në krye. Të gjitha këto datulla bien për -it. Si mend (Dëgjohet përsëri kushtimi i lëdrave që ngnjihashtë.) Prandaj të mbledhim rrëth vetes trimjig mat, dhe ta bëjmë zapimletin.

**MAXHAR PASHA** — Përndryshe ju piu e zeza.

**SHAQIR AGA** — E kemi bëre hesap edhe, të keqen, -em është o mikë i shëtipisë. I njohim ata jashtë më mirë se t'i veshim.

**BAJRAM AGA** — Mehmet Ali pasha ka të drejtë: të dalim dhe të mbledhim trimat.

**ABDULLA DRENI** — Këshfu, këshfu, o! Bajram agë. Ti do tu cosh fjalë miqve të tu dher miqve të mij, në Brash dhe në Malësi. Mos harro krenë, tafëdë, Hoshin e Nuri. I kam quan fjalë qëmenatë, Patër Pjetrit në Zym, nis dhe një shërbëtor tjetër. Ti, Masar agë, do të kalosh.

**Aj** gjenerali Klisyre i Komunës së Parisit nuk morë

në qytet me vërejtë sesi shkojnë punët (mas tanë).

SEJMENI — Si urdhëron që tashti!

MAXHAR PASHA — (Rëndë-rëndë.) Në goftë se do të rrosh në page, ngjish, armët e luftës, kanë thënë të parë.

ABDULLA DRENI — (Hyn, midis Bajram agës, e Shaqir agës.) Me këta dy trima që ka mikuyt në shtëpi, Mehmet Ali pashë, si ke shkat dron as për vëte, as për mua. (Shaqir Agës.) Ty, o Shaqir aga, dua me të mbajtë në konak. Më ke dhënë besën e burrave.

SHAQIR AGA — Besën ta kam dhënë. Abdulla Dreni dhe do ta mbaj. Bajraku im nuk ta ka dhënë ende, sepse besa e bajrakut, jepet me kuvend.

ABDULLA DRENI — (Bajram Agës.) Kur ju kam ju, do t'i kem edhe bajrajet tuaj. (T' drejtohet Hasan Batushës.) A nuk është kështu o Hasan agë Batusha?

HASAN BATUŠA — Nuk di si me të thënë, o Abdulla Dreni, në erdhëm hë konakun fund përujdi, por punët po marrin tjeter udhë...

MAXHAR PASHA — (Past) Është këshilluar me Adjutantin. Uhé kam besim te nxenësi dhe miku im, por nuk do të kishte asgjë të keqe, o Adjutant Abdulla sikurisht u hidhni i një syse toku salba oqrajeve tel tua? (Utdhërues.) Azëm dur! (Abdulla Dreni gatitet në vend dhe del me Maxhar Pashën, që Adjutantin e sulltanit e Sëjmenin.)

AZËM DUR — (Azëm dur, turq, që Gatiq, qarku i tij, është treguar) — AZËM LIA

**Dukja 4** q. Gajovida laza si q. vjet e tijve

**Ali Gucia, Shaqir Aga, Bajram Aga, Hasan Batusha, më vonë Abdulla Dreni, Mehmet Ali Dreni.**

**ALI GUCIA** — (Pas një heshtjeje të gjatë.) Mehmet Ali pasha nuk është miku ynë.

**BAJRAM AGA** — Edhe ti, Ali Pashë, më fjalët e Sulejmancit agë Vokshit? Si nuk qenka miku ynë!

**ALI GUCIA** — Sepse nuk na e do të mirën. Qé! Ashtu si thënë krerët e milletit, do vdekjén tonë. E nderon a s'e nderon ti Sulejman agë Vokshin, puna jote, por të vertetën e thuaj. Thartë na foli, por drejt.

**SHAQIR AGA** — Kur nuk qenka miku yt Mehmet Ali Maxhari, shka të them unë? Unë jam miku i Abdulla Drenit.

**HASAN BATUSHA** — As unë nuk e njihja, madje e dija se ishte me të vërtet kryqali.

**BAJRAM AGA** — Dhe unë zbrita në Gjakovë e rashi në konak të Abdulla Drenit. Këtu u rdhë e ra mik, edhe lajmësi i mbretit, Duam s'duam, miku i Abdulla Drenit është dhe miku ynë.

**SHAQIR AGA** — Domosdo. Abdulla Dreni e futi në shtëpi të dërguarin e mbretit, sepse na kishte ne pas krahësh. S'kemi si e lëshojmë.

**HASAN BATUSHA** — Ne endhem këtij me u marrë vesh, Maxhar Pasha, dhe Abdulla Dreni po gatitet përluftë.

**SHAQIR AGA** — E thash i zoti i shtëpisë së miku njihet mik në të keqë e në rrezik.

**ALI GUCIA** — (Shpërthen.) Në të keqe e në rrezik jam unë dhe Jakup Feri atje në kufi! (Ul kryj)

et dhe flet më shtruar.) Kur u nisë për Prizren, më coi fjalë bajraktarit i Hotit e më tha: «O, Ali Gucia, tj. që ke marré udhën me zbritë në Rrafsh për me takua Mehmet Ali pashe Maxharin, pyete atë të dërguarin e mbretit. A është e vërtetë se Turqia dëshiron me ja falë trojet tona Knaz Nikollës? (Hyn Abdulla Dreni përsëri.) Në t'u përgjegji se është e vërtetë, atëherë jakë të lidhim besën fis me fis, dhe të ngujohemi në keto malet tona kunder knazit dhe kunder mbretit.

**ABDULLA DRENI** — Edhe ti mendon me u lidhë me kaurët e Hotit?

**ALI GUCIA** — E di sé nuk ë kam râdhën me u lidhë as me krerëzit e miletit e as më kaurët e Hotit, Hoti e Gruda, Kelmendi e Mali i Zi kane qenë nën hyqmin tim. Unë kam qenë zot e atë sherbëtorë. Pór tashtë që unë kam mbetur rië udhëkryq? Të marr anën e Knazit? Të mëv është kapicën neokrye, të më hedhë gjedhën në qafë, të bëhem shërbëtor i shërbëtorit stim. Vdekjen e pianoj, turpin s'e durojci **ALI GUCIA** **ABDULLA DRENI** — Kush është thotë t'il nënshtrohesh Knaz Nikollës. Ty të nderon téré Mbretëria, ty të thonë Ali Pashë Gucia.

**ALI GUCIA** — Të le plangl e shkëpi, si thotë Mákhar Pasha, dhe të marr udhët e muhaxhurillëkut. Ali Pashë Gucia, Ali pashë Janxhia, Përse? Për keto tuje dhe keto nishane! (I shkul tujet e nishanët dhe i hedhë përdhë.) Na, na, na! I qofshin padishahët! Le t'i marrë prapë. Unë nuk i dua! Nderi më thërrret në malet e mia, të lidh besën e shqiptarit dhe të luftoj armiq-

— tê që më turrén. Kjo është udha ime: (Kalon vendosuri dhei del.)

**ABDULLA DRENI** — (Ngre duart përpjetë.) Hej, zot, n'a mbaj mendjen! (Të tjerëve.) Edhe ju, o burra, nëqoftëse u tutët nga kërët e miletit mund të shndeni me ikë. Unë nuk mbaj njëri më përdhunë.

**SHAQIR AGA** — Unë të kam dhënë besën, o Abdulla Dreni, nuk ndahem prej teje, do të vdes këtu. (Hyn me rrëmbim Mehmet Ali Dreni.)

**MEHMET ALI DRENI** — Babë or babë ka ardhë Tonni i Prenkes...

**ABDULLA DRENI** — Shka kërkoni cuni i Prenkë Gu-

lisë, në shtepinë time!

**MEHMET ALI DRENI** — Por Toni është mësuesi im...

**ABDULLA DRENI** — Bash për ato mësimë të buku-  
ra, që të ka dhënë, nuk dua ta shoh më sy.

**MEHMET ALI DRENI** — (I hutuar.) Por ai erdhi me  
Pater Pjetrin e Zymit, që është plak dhe  
mezi i ecën, kërsi i rëndësia me roj.

**ABDULLA DRENI** — (Ndryshe.) Paska ardhur Pater  
Pjetrin juri lutein tê dalim nga komaku, orët  
Pater Pjetri ka ardhë me takua Mehmet Ali  
Pashën.

**MEHMET ALI DRENI** — Kanë zbritur kaq shumë  
malësorë, në qytet sa mezi kalohet udhëve.  
Edhe nga dritat e katit tê sipërm duken ma-  
tanë Përronit (plisat) e bardhë tufat-tufa... (Ni-  
sen tê dalin. Bajram Aga në kalm ulet e merr  
nishanet e hedhurtë (përdhie).)

**Plisat** → kapuçat

Dukja 5.

Maxhar Pasha, Pater Pjetri.

MAXHAR PASHA — (Hyjnë, përkrah njeri-tjetrit.)

Kam dëgjuar se flitet me nderim të madh për  
një jetjë, hirësi, si ndër të krishterë edhe ndër mu-  
hammedanë.

PATER PJETRI — (I përvutë:) Nuk ankohem, mar-  
shal i ndritur. Në Perandorinë Otomane feta-  
rët janë njerëzit që nderohen më shumë, pas  
ushtarakëve, kuptohet. (I bën: under shokut të  
dalë. përparrë.)

MAXHAR PASHA — Danke schön<sup>1)</sup> — Vetëm se nde-  
rimit ndaj ushtarakëve i bën hije një drojë e  
lehtë.

PATER PJETRI — Naturlich<sup>2)</sup> I pushtetshmi le pas  
hijen e drojës.

MAXHAR PASHA — Kjo drojë është e dobishme.

PATER PJETRI — E domosdoshme! Pa të bota do  
t'ishte një pështjellim.

MAXHAR PASHA — Një trajtë e drojës ndaj pë-  
rendisë

PATER PJETRI — Jepni Cezarit shka i takon Cezarit.

MAXHAR PASHA — (Lajkatus.) E folki gjermanish-

ten bukur, Pater Pjetri, me një theks vienez.

PATER PJETRI — Studimet i kam, nisur në Venetik.

Kami qenë edhe në Vjenë... Nuk mund të kre-  
nohem se e flas si në rini. S'kam rassë me e  
përdorë gjermanishten përpos letërkëmbimit  
tim me eprorët.

1) Dante schöm — faleminderit shumë

2) Naturlich — natyrisht.

**MAXHAR PASHA** -- Austria është përkrahësja e pusihtetshme e katolikëve shqiptarë.

**PATER PJETRI** -- Kush tjetër?

**MAXHAR PASHA** -- Edhe finansiarisht ju jeni nën proteksionin e Vjenës.

**PATER PJETRI** -- Po, po. Aushtria është shteti më i madh shumëkombësh, që ka në themel të vërt feni katolike. *Austriæ est imperare orbis universo.* Austrisë i takon të urdhërojë botën. *Et te situm est regnum mundi.*

**MAXHAR PASHA** -- Botën e krishterë.... Ndërsa Turqisë i takon të urdhërojë botën muhamedane. *Qui regnat per orbem terrarum.*

**PATER PJETRI** -- Të kundërtat që ndihmohen. Austria e përkrahu Turqinë në Kuvendin e Berlinit. *Qui regnat per orbem terrarum.*

**MAXHAR PASHA** -- Edhe ne u zotuam mos me e prekë autonominë e Mirditës katolike.

**PATER PJETRI** -- Ju faleminderit për dashamirësinë tuaj.

**MAXHAR PASHA** -- Bitte schön!...<sup>1)</sup> Jetojmë në kohë të vështira, Pater Pjetri. Lufta ruso-türke ka përtërirë armiqësi të vjetra fëtare në tërë Perandorinë. Edhe shqiptarët janë acaruar shumë... Ai ka pasur shpërthime të dhunës ridaj popullsisë së krishterë?

**PATER PJETRI** -- Shqiptarët nuk janë të ndjeshëm ndaj fesë. Feja e vjetër shikohet si një trashëgim ritual, feja e re si një përfitim material... Polemi nuk i kupton vlerat shpirtërore të fesë. Ai ka mbetur pagan. Kjo është vërejtja ime e hidhur prej fetari. Lidhjet e shqip-

1) Bitte Schön -- ju lutem shumë.

tarëve më përkatësi, të ndryshme fetare janë të fuqishme. Kështu Abdulla Dreni, miku juaj ka miqësi, sa me muhamedianët aq edhe me kristianët.

MAXHAR PASHA — (Me buzëqeshje.) Edhe ju jeni ndër miqtë e tij.

PATER PJETRI — E numroj veten si të tillë:

MAXHAR PASHA — Edhe pas jush besnikët tuaj.

PATER PJETRI — (E miraton me kokë.) Natürlich!

MAXHAR PASHA — Unë ju thirra, që tju njoftoh me telashet që na kanë dalë pas Kuyendit, të Berlinit. Emorët vesh se në Prizren më paditën si gjaurje mynafik. Unë u përpoqja, të shpëtoj Perandorinë Otomanë. Dhe e shpëtova. As Plavën e Gucinë nuk desha t'ja lëshoi Knjaz Nikollës, se kishin një popullsi myslimanë. U orvata, por as Austria nuk pranoi, të lëshojë trojet e Hercegovinës, që i desh për vete. Dhe ulë kryet, lëshova..., nënshtkrova. Fuqitë e Mëdha janë me të vërtetë të mëdha. Dhe ne mundishim të mundur... Në mbarim flet me këq-ardhje.)

PATER PJETRI — Vae victis!<sup>1)</sup>

MAXHAR PASHA — Po, mjerë të munduri! (E smerr veten.) Ne nuk duam që acarimi i shqipëtarëve ndaj Evropës, të kthëhet kundër nesh...  
Mifaku i Prizrenit po nall ngatërron. Krerët shqiptarë nuk kuptojnë gjendjen nga e cila mezi dualëm, tërheqjej e pashmangshme. Nuk dinë ç'ëshë politika, diplomacia... (Si me të qeshur:) Një hokatarinë pallati i krahasoit padit shakun tonë me një thoxhë të spazot, që me

(1) Vae victis (latinisht), = mjerë të mundurit.

duvatë e tija i mblodhi xhindët e Arnautllukut  
në Prizren, por tashti nuk është në gjendje që  
t'i shpërndajë... (Qesh.) Shaka me kripë.

PATER PJETRI — (Qesh edhe ai.) Prandaj ju dërgoi që nga Stambolli me kuran në dorë t'i  
shpërndani ju...

MAXHAR PASHA — E keqja është se duvaja ime  
në Bajrak Xhaminë e Prizrenit i tërboi  
krejt xhindët e Arnautllukut. (Vazhdojnë  
të qeshin.) Mos keni ju, o Pater Pjetri, ndonjë aftesi për t'i larguar xhindët me ungjill?

PATER PJETRI — Me sa të kemi mundësi nuk do  
të kursehem, por miletë është milet...  
(Ngre dorën e djathtë përpjetë. Dëgjohet  
një krisëm hute pastaj kënga e majekrahit:

«Mic Sokoli, o pika e trimit,  
Priji djemtë e vegjelimit  
Në sarajet e parësimit!

piskamë nga të gjithë anët dhe pastaj një batare  
pushkësh.)

Dukja 6:

Maxhar Pasha, Pater Pjetri, Abdulla Dreni, Shaqir Aga, Bajram Aga, Malësori I, Ma-  
lësori II, Malësori III, Malësori IV, Mic Sokoli, Hyça

MAXHAR PASHA — (I kapun në befasi.) Ç'është  
kjo zallahi?

ABDULLA DRENI — (I trembur për mikun.) Di-  
sa malësorë të armatosur kanë hyrë në sa-  
rajet e mia krejt papritur.

MAXHAR PASHA — (I përngritur.) Ç'duan të tre-

gojnë me këto thirrje e me këta dyfekë. Se janë trima. Hapni dyert të urdhërojnë! Unë nuk trembem nga të lehurat e qenve të pazarit. (*Niset drejt derës së jashtme.*)

ABDULLA DRENI — (*E ndalon.*) Mengadale, Mehmet Ali Pashë, ti nuk e njeh mirë këtë milet.  
SHAQIR AGA — (*Që porsa ka hyrë.*) Këto janë këngët e majekrahit, piskamët e sulmit: malësorët tanë ja behën.

BAJRAM AGA — (*Duke hyrë.*) Mos i nxirri kryet në dritare se të gjitha hutat e Gjakovës po shkrehen më këtë konak.

MAXHAR PASHA — (*Gjithmonë i shqetësuar.*) Po rojet, rojet ku janë?

ABDULLA DRENI — Të dalim që këtej derisa të qetësohen...

PATER PJETRI — Ejani, Marshal Detrua. I zoti i shtëpisë ka njerzitie vet që do t'i bëjnë zap të pabindurit. Të dalim sipas këshillës së Abdulla Pashë Drenit. (*Dalin që të tre. Në konakun e miqve vërhojnë malësorët.*)

MALESORI I — Ku është ai i dërguari i mbretit?

MALESORI II — Ku është armiku ynë?

HYSA — Ku është futur Maxhâr Pasha, qenif i pasbesë?

SHAQIR AGA — (*Përmban malësorët.*) Ndaluni, bre burra, ku shkoni?

BAJRAM AGA — (*Edhe ai duke penguar sulmuesit.*) Mengadale, mengadalë të merremi vesh. (*Të shtënët rrallohen.*)

SHAQIR AGA — A ë dini se kjo shtëpi ka zot:  
Ku jeni, në han?

MALESORI III — E dimë që kjo shtëpi ka zot,

por ne kemi ardhur pér atë mikun e Stambollit.

MALESORI IV — Duám Maxhar Pashën.

SHAQIR AGA — Ju' qenkan lëbyrë sytë, bre burra! Qysh hyni në shtëpi të tjetrit si kusarë. Pa mendohuni mirë shka flisni. Na koritet! (Malesorët e njohin dhe ndalen.) A dorezohet miku? Jeni a s'jeni burra?

MALESORI I — (I habitur.) Po ti, si qëndron këtu, o! Bajram aga? Në konak të Abdulla Drenit? Ai ka tradhtuar Lidhjen Shqiptare.

BAJRAM AGA — Ju' kanë rrejtë. Prisni të bisedojmë.

MALESORI II — (I befasuar.) Shaqir Aga dhe Bajram aga të dy bashkë, në konak të Abdulla Drenit! Por këta janë në gjak njeri me tjetrin.

BAJRAM AGA — Në gjak kemi qenë dje, por sot nuk jemi. Kështu na e do e mira e vendit.

SHAQIR AGA — Prandaj ndaluni dhe ndëgjoni!

MIC SOKOLI — E qysh të të ndëgjojmë, o i pari i fisisit? Të shoh e nuk të njoh. Ti roje e Maxhar Pashës?

SHAQIR AGA — Unë nuk i kam dalë krah Maxhar Pashës, por Abdulla Drenit, kryetarit të Lidhjes Shqiptare, në Gjakovë, pér marrëveshje e pajtesë.

MIC SOKOLI — Ti më nise me këto dy gjarpëru she në Malësi, unë e dhashë kushtrimin dhe burrëria e fisisit zbriti në Gjakovë.

SHAQIR AGA — Bukur mirë ke vepruar, o Mic Sokoli. Trimat e bajrakut të zenë vend matanë Pérroit, unë do të qëndroj këtu. I kam dhë një besën Abdulla Drenit. Do të mundohem

me e pajtua me shokët e Lidhjes Shqiptare. Nëqoftëse nuk ja dal me i pajtua, dhe me bindë Maxhar Pashën të kthehet imbrapsht në Stamboll, por nis lufta e vëllavrasja midis nesh, atëherë këto dy gjarpërushët e mia m'i shpraz mua në kraharor.

MIC SOKOLI — (Me dhimbje.) E qysht të t'i shpraz

ty, o Shaqir Aga, të kam të parin e fisit. SHAQIR AGA — Vramë, premë, shidhmë tej pa u trembur, të mbetem për të tjerët një shembull, që nuk duhet ndjekur. (Dëgjohet përsëri një batarë pushkësh.) Por tashti dëgjoma këshillën time: dil te dërá, dhe lyp' besë. Nuk kemi tjetër shteg për t'u marrë vesh.

MIC SOKOLI — Eshtë hera e dytë që po më ndal vrellin, o bajraktar. Por dije se rruga që kë marrë po të ndah prej fisit. (Shkon te dera dhe thërrret.) Besa-besë, bre burra! Besa besë! (Që jashtë përgjigjet një zë i fortë: «Besa-besë, prani hutat!») (Ndërkohë Bajram Aga ka dale për t'u kthyer me Abdulla Drenin më vonë. Qetësi.) A e dëgjon, o Shaqir Aga, eshtë Man Avdia.

ABDULLA DRENI — (Hyn në konak duke zbritur nga shkallët.) Shika janë këto batare, Mic Sokoli. Pse nuk vini me u marrë vesh?

MIC SOKOLI — Ne e nisëm një dërgatë dhe ju nuk e dëgjuat. Milet i zemërua dhe t'u turr brenda në konak mbasi ka marrë vesh se ti mban Maxhar Pashën. Maxhar Pasha ka ardhë me vendosë kufirin në Plavë e në Guci.

ABDULLA DRENI — Unë nuk pyes fare për milet. Jam nga ata burra që ja vendos kufirin mi-

që lëtit joatje në Plavë e Guci, por këtu në Livojadhet e Piskotës.

**MIC SOKOLI** — E shkà kujton ti, o Abdulla Dreni, se nës Shqipëria është çifliku yt që t'ja vendosësh kufirin ku t'ë duash. Pasha qie llin e pasha dheun! Ti nuk do të ndahesh mirë me ne.

**ABDULLA DRENI** — Fjala-fjalë e besa-besë! Dua tri ditë besë prej jush.

**MIC SOKOLI** — Ke një ditë besë. Deri nesër në drekkëkëtë armik që ke në shtëpi ta nxjerrësh ja shtëpi kufirit të Gjakovës.

**ABDULLA DRENI** — Unë jam burrë e nuk kori tem: Mikun e kam në shtëpi dhe do ta mbaj, nuk e jap.

**MIC SOKOLI** — Ne nuk ta kërkojmë ma na e dhanë. Të kthehet nga ka ardhur në Stamboll.

**ABDULLA DRENI** — Maxhar Pasha nuk kthehet mbrapsht.

**MIC SOKOLI** — Më qafë pastë veten. Do t'i mben ten eshtrat në Rrafsh.

### (Bie sipari.)

— Më i lindur që dëgjatet me bështët e tij  
— Më i lindur që dëgjatet me bështët e tij  
— Më i lindur që dëgjatet me bështët e tij  
— Më i lindur që dëgjatet me bështët e tij

## V E P R I M I IV

— Në dëgjatje e tij, që dëgjatet me bështët e tij,  
ta shkruhet këtoqjet e tij, që dëgjatet me bështët e tij,  
dëgjatet me bështët e tij, që dëgjatet me bështët e tij,  
dëgjatet me bështët e tij.

**A. Pamja nga rruga.**

**Te sheqerxhihana e Sili Bozaxhiut.**

— Edhe sot, që dëgjatet me bështët e tij, — 012 a.D.  
dëgjatet me bështët e tij,

**Dukja 1**

*Bozaxhiu, Ganiu, Shpendi, Hoxhë, Qitapi,  
Mujë Muhxaxhiri.*

**SHPENDI** — (Hyn me një kosh, por edhe një kar-  
rajfile supit.) Oq Sili, Bozaxhiu, ta prura edhe  
sot borën.

**BOZAXHIU** — (Pasi e ka vënë rre.) E paske hedhur

edhe karajfilen supit.

**SHPENDI** — Eshtë dita e saj.

**GANIU** — Prej nga ke zbritur, o burri i dheut?

**SHPENDI** — Prej Malësisë së Gashit. Jemi nda-  
lur aty rrrotull. Taqes së Shehit, të gjithë  
burrat e fisit. Na prin Ali Ibra.

**GANIU** — Hej, ju, priftë e mbarat!

**BOZAXHIU** — (I pagugan parat.) Ja hesapin.

**SHPENDI** — Deri sa të lajmëhesapet me Maxha-  
rin e me parësimin, që e ka marrë në ndo-  
re, o Sili, Bozaxhiu, nuk do të kemi më he-  
sap bore. Ika se më presin shokët. Tungja-  
tjetani!

**BOZAXHIU** — (E përcjell.) Tungjatjeta, o Shpend

Hekakeqi! Të fala atyre miqve të Gashit. (Ve-te t'i shérbejé Ganiut. Hyn nē sheqerxhihe-ne. Dégjohet që larg një lodër.)

GANIU — (Pasi hedh një vështrim nga vjen zhurma e lodrës.) Po të vjen Hoxhë Qitapi, o Sili Bozaxhiu. I bëj gati edhe ndonjë thumb.

BOZAXHIU — (Nxjerr kryet nē dritare.) Gati ja kam, por prapë nuk don të largohet. Është si ai gomari i zgjebur, që vjen e kruhet këtu nē sheqerxhihanën time. Edhe i ha edhe i djeg...

GANIU — Shakaja e thumbon, hallvasia e émbelson, prandaj nuk largohet.

HOXHË QITAPI — (Hyn me qitap nën sqetull.) Nuk e bëj atë punë e nuk e bëj. Nuk e merr qitapi, o Mujë Muhaxhiri!

MUJË MUHAXHIRI — (Pas tij duke iu lutur.) Qysh nuk e merr qitapi. Ti ke dalë mendsh.

HOXHË QITAPI — Unë jam sagllam, ju keni dëgjoni mendsh, o muhaxhire. Keni qitur pushkë mbi të dërguarin e kalifit... Lam Muhaxhiri shkoi lanet. Nuk e merr qitapi me e varrosë sipas adetit. Merr vesh a nuk merr vesh... O Vasil Bozaxhi, hallvasi!

BOZAXHIU — (Nxjerr kryet nga dritarja.) Peqe, Hoxhë Kurshumlia!

MUJË MUHAXHIRI — (I afröhét Ganiut.) A dëgjoni ti, Gani efendia, ky hoxha ynë nuk është në vete! Dje më drekë në dyfek të parë me askerët e Maxhar Pashës na u vra Lam Muhaxhiri, ky nuk pranoñ me e kallë hë dhë sipas adetit. Lami u vra në luftë me askerët e atij murtatit që na çoi mbreti nga Stambolli...

**HOXHË QITAPI** — Mehmet Ali Pasha muhamédan  
me din e iman, jo murtat!

**BOZAXHIU** — (Pasi i ka shërbyer.) Hehet! Hala  
ke tura, Hojhë Shemskedini! Tat! thashë që  
dje se kadilerët e myderizët e vilajetit tonë e  
shpallën Maxhar Pashën murtat.

**HOXHË QITAPI** — As kadiu i Gjakovës Ahmet Ko-  
ronica, as myderizi i Prizrenit Ymer Efendia  
nuk gjykon Mehmet Ali Pashanë. Jo e jo.  
Sheriati gjykon po Miletin vilajet Kosovës  
sëert mlet, nuk dëgjon kalif, ulema a pasha  
haçreflerët, por dëgjon myderiz, kadi e kaçak  
fermanli... Lam Muhamxiri me shokë pse nuk  
shkoi askerët luftë me Knjaz Milani të më-  
rrë vatanin tonë në Vranjë, Kurshumli Mjaft  
seido të ha hallvasi...

**BOZAXHIU** — (Mënjanë.) Haje, haje... ta hëngsha!...

**MUJË MUHAXHIRI** — Ky nuk rron në këtë botë.  
Ne ju nisëm askerë ashtu si na thanë ca për  
në Tivar e ca për në Vranjë, por ku na deg-  
disën pashallarët? Në Bosnjë. Pse? Që të  
mbronim çifligjet e tyre. Dhe ne ikëm, mu-

arrmë aratinë...

**BOZAXHIU** — Hoxhë Qitapi, hoxhë fesati ha hall-  
vasinë dhe mos na mbill në Kosovë dasinë.

**HOXHË QITAPI** — Ti u del krah shkjeve, Vasil Bo-  
zaxhi. Ti je vete shkja.

**GANIU** — Mblidhe mendjen, hoxhë efendi. Knjaz  
Milani me askerët e tij ju prishi vatanin, ju  
la pa plang e pa shtëpi juvë... Ai e kreu këtë  
mizori. Të bëjmë edhe ne si ai? T'i vemë ve-  
tes një njollë turpi që të mos na hiqet kurrë.  
Jo. Burri për një ndër rron në këtë botë. Në-  
goftëse qitapi yt thotë kështu, hiq që këtej

ushtomme gjith' qitapa. Të mos ta shohim bojën. Ec e mbyllu në sarajet e Abdulla Drenit me

murtatini. (Dëgjohet përsëri lodra.) HOXHE QITAPI — (Nxjerr paret e paguan.) Ti je murtati Gani efendi. Nuk ke din as iman si muhamedan, as ti as Muja. Përse kërkoni t'i këndojet fatihancë Lan, Muhaxhirit. Meazallah!

Këto nuk janë lodrat e dovetit. Lanet, lanet! BOZAXHIU — Këto janë lodrat e miletit, që do të

ngrehin më këmbë Gegérinë e Teskérinë, gjithë Shqipérinë. HOXHE QITAPI — Kur ngue krye mileti, vjen kja mieti. (Del)

GANIU — Edhe ti, o Sili Bagëri, e prisje përditë Ho-  
xhe Qitapin me nga një shaka, më nga një thumb. MUJË MUHAXHIRI — Ky do një plumb. (Lodra dë-  
gjohet më fort...)

Dukjan 2. di

Tellalli i ri, Bozaxhiu, Ganiu, Mujë Muhaxhi-  
ri, Met Koronica, Toni i Prenkës.

TELLALLI I RI — (Hyn duke i rënë lodrës, ndalet  
e thërritet). Hej, dégjoni e mbani vesh:

«Kush është kryeluftëtar,  
i parë fisi e bajraktar,  
i parësimit a i vegjelimit,  
nga malësia, fusha e qyteti  
Në Terzihane, të zateti,  
imbasi sot në zemërherë  
mban kuwend Lidhja Shqiptare!»

**BOZAXHIU** — (Te deriu e qoshkut.) Hëfiz u shkofë  
puna mbare! (Tellalt i Rindë duke i rënë  
tëdres, degjohat fëdhe një herë fjalë e tij.)

**MET KORONICA** — (Hyn i pari) Kështu që ti, o  
Toni i Prenkës, e pëske njohtur Tahir Efendi  
dinë në Stamboll.

**TONI I PRENKËS** — (Pas tij më krahë të majtë.)  
Më shpuri Gjon Vreta në shtëpinë e tij. Sa  
i u bë qejfi kur mori vesh se isha gjakovar!

**MET KORONICA** — Prej tij nxurë më e shkrua  
shqipen une...

**TONI I PRENKËS** — E di... Tahir Efendi kish  
pasur mësues Mulla Hysenin. Më foli më  
dashuri të madhe për të.

**MET KORONICA** — (Me naderim.) Mulla Hyseni  
ishte një shenjt i gjallë. Sa shumë pat vuaj-  
tur nga pashallarët edhe ai! Dhe përsë! Se  
shkruante shqip më harfe arabe.

**TONI I PRENKËS** — Edhe ata që e kanë shkruar  
shqipen me gërmë greke e latine kanë vuaj-  
tur. Disa kanë dhënë jetën për ndricimin e  
shqiptarëve. Pjetër Budi u mbyt në Drin,  
Naum, Vithkuqari u helmua në Stamboll,  
Dhaskal Todhri u vra udhës... Kush është  
dora që ndjek e përndjek,<sup>1)</sup> që mundështon<sup>2)</sup>  
e vret ndricimtarët tanë? Kush është gjemë-  
madhi? Papati, Patrikana, Kalifati...

**MET KORONICA** — (Ndalet në vend.) Këtë fjalë  
mos e thuaj.

**TONI I PRENKËS** — Kështu, është kadi efendi.

1) Përndjek — persekuton

2) Mundështón — torturon

MET KORONICA — (I ven dorën në sup.) Edhe unë jam kokëshkretë, por nuk i them të gjitha...

A ulemi të pijmë nga një bozë të ftohtë te Sili Bagëri, se edhe ky bozaxhiu i Rekës është dmiku i Gjon Vretës. (I afrohen një tryenze.) O Sili Bagëri, na bjerë nga një bozë të ftohtë!

BOZAXHIU — (Nxjerr kryet nga dritarja.) Peqe, kadi efendi, erdhali!

TONI I PRENKËS — (Duke u ulur) Ndoshta po ti thuash të gjitha ato që di, do të të quanin të pafe si Hoxhë Tahsinin e Çamërisë.

MET KORONICA — Mos e hap atë defter...

BOZAXHIU — (Sjell dy gota.) Ju më porositët dy gota bozë, unë ju prura dy gota sherbet me borë bieshkësh. E keni nga unë këtë sherbet me borë nga Shkëlzeni.

MET KORONICA — Të falemi nderës, o Sili Bagëri, nuk po ta kthejmë dorën. Por a mund ta dijmë përsë po na qeras?

BOZAXHIU — Për ato fjalë të tharta që ja u përplasë pa shallarëve, parësimit dhe mikut të mbretit mu në mes të mëxhelisit. Fjala bramb' dhe huta bamb! Ta marrë vesh Mehmet Ali Pasha se Lidhja Shqiptare në Gjakovë ë ka barutin të thatë.

MET KORONICA — Por a e di se disa nga pleqtë e Gjakovës më qortuan, se u rrëmbeva. Ata ja zgjatën besën Abdulla Drenit edhe tijë ditë të dytë.

BOZAXHIU — Mos u mërzit, kadi efendi. Edhe ata të Pleqësisë do të vijnë në fjalën tënde. (Largolet.)

MET KORONICA — Sherbet me borë Shkëlzeni.

(E trazoni me lugë! Po ato lëvizje bën edhe Toni i Prenkës. Që larg dëgjohet zëri i myezinit? «Allah akbar!, Allah akbar!» Iqindi!... Mulla Kamberi i thërret pesë vaktet si turqit: Allah iqber! Kurse Mulla Rushani si nati arabëti Allah akbar! Përse t'i lutemi perëndisë në gjuhë që nuk i merr vesh millet!

TONI I PRENKËS — (Përitu larguar prej milletit...) (Dëgjohet tingulli i një këmbane, i cili përzihet me ushëtimën e fjalëve Ditet me myezinit.) Edhe Pater Pjetri po i thërret besnikët në kishë, në zëmërherë. Edhe ai i thotë perëndisë latinisht: Pater noster.

MET KORONICA — Ayure re, o Toni i Prenkës, se zëri i myezinit u bashkua me tingujt e këmbanës? Edhe ne duhet të përpinqemi me i bashkua fetë e ndryshme në Shqipëri.

TONI I PRENKËS — Bashikimi i feve dhe i feta-reve, në Shqipëri është një punë shumë vështirë, sepse kreu i tyre është tjetërkundi, te amiqtë tanë, Prandaj na kanë sjellë përçarje. Prishja e feve, thotë Gjon Vreta nuk është punë e lehtë as detyrë e vetë shqiptarëve...

MET KORONICA — (Duke u ngritur më këmbë:) Atëherë si t'ja bëjmë?

TONI I PRENKËS — (Ngrihet edhe ai.) Në do të bashkohemi duke lënë mënjanë fetë: «Të mos shikojmë kisha e xhamia, feja e shqiptarit është shqiptaria» (Të dy gatiten të shkojnë. Afrohet Bozaxhiu.)

MET KORONICA — O Sili Rekalliu i Dibrës, të falë së lemtidëres!

BOZAXHIU — (Si me drojtje.) Ju keni mëkuvend

tashti, o kadi efehdhi, por unë kam edhe një rixha...

MËT KÖRONICA — Lepe, hap gojëni e fol!

BOZAXHIU — Ky Mujë Muhaxhirin ka një fjalë me ty, por druhet me të folë:

MËT KÖRONICA — Si kështu, o Mujë, ne jemi miq...

MUJË MUHAXHIRI — Djë na u vra në luftë me askerët e Maxharit Lami...

MËT KÖRONICA — Rahmet xhan! T'i rrojnë qunat! E mora vesh...

MUJË MUHAXHIRI — Ne e shpumë me e varrosë te Livadhet e Piskotës, se 'ashtu deshën fëmja, me e pasë pranë kësollavé.

MËT KÖRONICA — Shumë mirë paskeni bërë.

MUJË MUHAXHIRI — Mirpo tashti hoxha ynë nuk ndëgjon me ná e kallë né dhë sipas adëtit... Nuk e merr qitapi me e varrosë Lam Muhaxhirin sipas adëtit të myslimanit, se është vrarë në luftë me të dërguarin e kalifit.

MËT KÖRONICA — Hoxhë Shemshedin Kurshumlia kështu?

MUJË MUHAXHIRI — Ai vete.

MËT KÖRONICA — Shumë mirë që erdhe, të më japësh haber. Do të vij vete në Livadhet e Piskotës t'ja këndojet fatihanë Lam Muhaxhirin.

TONI I PRENKËS — Shumë punë të njerëzisë nuk merr qitapi i Hoxhë Kurshumlisë, por i merr qitapi i Met Koronics.

(*Papritur dégjohet një krisëm e largët pushke. Heshtje.*)

BOZAXHIU — Po kjo karajfile c'është? Jemi a s'jemi mi në besë?

MET KORONICA — Nuk është karajfile, por ësh-të martinë bajliku. E ka marrë të re ndonjë trim dhe e ka shkrepur për qejf.

GANIU — Sa bukur që i ardhka krisma prej së largu.

TONI I PRENKËS — Hoxhë Met Koronica është edhe i divitit, edhe i gishtit.

MUJË MUHAXHIRI — Hej, unë i shkreti u dogja për një martinë... Tri lira janë shumë për Mujë Muhaxhirin.

MET KORONICA — Dil nesër në Fushën e Bajram Pashës dhe e merr pa para. Atje do të presin taborin që vjen nga Mitrovica, trimat e Mic Sokolit. (Përshëndeten.) Shko përpara në Lividhet e Piskotës e i qetëso ata njerëzit e Lam Muhaxhirit. (Dalin të gjithë, përveç Bozaxhiut, i cili mbledh gotat në tryeza.)

BOZAXHIU — Mor po ajo martina sikur krisi në Sarajet e Abdulla Drenit. Mos kanë ardhur fandët dhe ndonjë trim prej tyre e ka shkrehur martinën... (Del.)

### B. Pamja nga shtëpia e Prenkë Gulisë.

Kthimi i miqve si në veprimin II. Është natë.  
Një kandil mbi vatër.

#### Dukja 1

Mrika, Hoshi i Nurit.

HOSHI I NURIT — (Këmbëkryq pranë një tryeze buke.) Çoje tryezën, moj Mrikë.

MRIKA — (Qëndron më këmbë.) Po ti nuk hëngre, fare, o im vëlla.

**HOSHI I NURIT** — Kisha ngrënë gjetiu... Më mbush një gotë ujë, po deshe. (*Mrika merr shtambën dhe ja mbush gotën. Hoshi i Nurit e pi me afsh.*) Të kënaq ky ujët e pusit tuaj: edhe i ftohtë, edhe i lehtë. Çoje tryezën, çoje! (*Mrika merr enët dhe tryezën, del nga dera e djathtë.*) Ju prisnin në katund para dy javësh. Na çuat fjalë se do të vinit. Do të kënaqeshit... Këtu qenka vapë e madhe.

**MRIKA** — (*Duke hyrë.*) U bëmë gati me ardhë, por na dolën disa punë. Burrat kanë pasur shumë telashe kësaj vere. (*Sikur kujtohet për diçka.*) Toni desh me të takua. A do të rrish gjatë në Gjakovë?

**HOSHI I NURIT** — Nuk dij, moj motër. Po të mbaroj punë shpejt, nuk kam pse të rrrij... Kallambiqi u dogj për ujë.

**MRIKA** — (*Pasi u ka hedhur një sy armëve të vëllait.*) Përse ke ardhur i ngjeshur me armë?

**HOSHI I NURIT** — A mund të vihet ndryshe këtu në këto ditë!

*Hyn Prenkë Gulia, Mrika largohet ngadale.)*

## *Dukja 2*

*Hoshi i Nurit, Prenkë Gulia.*

**PRENKË GULIA** — (*Duke hyrë.*) Mirë se erdhe, o krushku Hosh!

**HOSHI I NURIT** — Mirë se të gjeta, o krushku Prenkë!

**PRENKË GULIA** — Mos ju ka thirrë Abdulla Dre-ni?

**HOSHI I NURIT** — Ai vetë na ka çuar fjalë, mbasi është këshilluar edhe me Patër Pjetrin.

**PRENKË GULIA** – (*I befasuar.*) Nuk është e mundur.

**HOSHI I NURIT** – Na e tha me gojën e vet Bajram Aga,

**PRENKË GULIA** – A jeni shumë burra?

**HOSHI I NURIT** – Ndonja tridhjetë fandë. Mundet të vijnë edhe të tjerë. Që dje ja befti lajmësi me na thanë se Abdulla Pashë Dreni është në rrezik të madh e kush është miku i tij, të bjerë sa më parë në Gjakovë, te sarajet matanë Përronit.

**PRENKË GULIA** – A e din ti, krushku Hosh se çfarë rreziku i gjermushet Dullë Drenit?

**HOSHI I NURIT** – Dij se ja ka mësye shtëpinë një mik nga Stambolli, i dërguari i mbretit, e thirkan Mehmet Ali pashë Maxhari. Ky mik u paska kthyer mysliman. Me të ardhur në Gjakovë, si dashamir i të krishterëve, thirrka në kuvent të parësimit edhe Patér Pjetrin... Shi për këtë vjegëz<sup>1</sup>); se i dashka të krishterët, e paska sharë e fyter mileti i Prizrenit. Kinse duke qenë kryqali, paska edhe gisht me krajlitë e krishtera të Evropës. Parësimi i Pejës, trembur nga polemi, i paska kthyer shpinën në atë rrëmujën e madhe përpara Xhamisë së Bajrakut. Abdulla pashë Dreni, si burrë zakoni, nuk e la mikun në mes të rrugës, por e grishi në Gjakovë, dhe e mori në ndore.

**PRENKË GULIA** – Pasha Zotin! Bulkur ju pas-

---

1) Vjegëz = pretekst.

ka përrallë Dullë Dreni; por punët nuk janë ashtu. Ulu, ulu të flasim shtruar. (*Nxjerr kutinë e duhanit. Hoshi i Nurit ulet përdhe, ndërsa i zoti i shtëpisë në një shkamb.*) Polemi i Prizrenit nuk e shau dhe e pështyu Maxhar Pashën, se paska qenë kryqali. Ai nuk është kryqali, por turk osmanlli me din e me iman. As polemi i Rrafshit dhe i Malësisë nuk e ndezi luftën me taborin e turqve në sarajet e Dullë Drenit, se paska gisht me krajlitë e Evropës. Jo, or krushku Hosh, jo! Ky sherr u ndez sepse ky i dërguari i sultani Abdyl Hamitit rreket me mish e me shpirt që trojet e Shqipërisë, Plavë e Guci, t'ja lëshojë Malit të Zi.

**HOSHI I NURIT** — Mirë bulkur, o krushku Prenkë, unë nuk i di pér fije e pér pe këto punë. Ti je i ditur e i shetitur, ti qytetar e unë katundar. Por unë di se miku nuk i preket të zotit të shtëpisë, as i preket, as i gërgitet. Kështu na e kanë lenë të parët me kanun. Dhe me kanun i zoti i shtëpisë është në rregull. (*Mbaron së dredhuri cingaren e duhanit, e ndez me masat dhe e tërheq një herë.*)

**PRENKË GULIA** — Kot rreket me u kapë pas Kanunit të Maleve Abdulla Pashë Dreni. Armiku i Shqipërisë s'ka si të jetë miku i shtëpisë. Sipas Kanunit të Maleve, kush kryen një tradhëti të dhunshme ndaj fisit, ai vritet e grihet, fisi i shkul themelet e shtëpisë. Dhe shkon gjakhpës. Kështu do t'i ndodhi Abdulla pashë Drenit, po nuk e përçolli pér në Stamboll të dërguarin e mbretit. Në qoftë se deri nesër në mesditë Maxhar Pasha nuk

ndëgjon me ikë, Lidhja Shqiptare me luftëtarët e saj do ta mësyejë brenda në sarajet dhe do ta vrasë. Prandaj ti nuk ke pse shkon matanë Përronit. Ti do të rrish këtu.

HOSHI I NURIT — (*Lë cingaren mënjanë.*) Unë s'kam si ndalem këtu. I dhashë besën Bajram Agës dhe ai më pret.

PRENKE GULIA — (*I pezmatuar.*) E pse të ta kërkojë besën ty Bajram aga? Për me u vra vëlla me vëlla? Ti s'ke pse shkon me u ngujuja në sarajet e Abdulla pashë Drenit. As ti, as malësorët fandë. Ai ka pse me u ngujuua. Maxhar Pasha i ka dhënë nishanin e bimbashit në ushtrinë e mbretit. Juve ju kanë kérkuar besën që t'ju shtjenë në kurth.

HOSHI I NURIT — (*Me hidhërim.*) Ndoshta është kështu si thua ti, o krushku Prenkë...

PRENKE GULIA — (*Me ngulm.*) Kështu është.

HOSHI I NURIT — Po unë s'kam si ndahem prej shokësh e prej miqsh.

PRENKE GULIA — (*I përngritur.*) Por si të shkosh e të luftosh me vëllezërit e tu? Ja, im bir Toni, yt kunat bashkë me katundarët e kristerë të Zymit kanë marrë hutat dhe janë bashkuar me malësorët e tjerë. Aty i ke, më këtë anë të Pérroit, përballë sarajeve... Ti don të shkosh matanë Pérroit me u ngujuua në sarajet e Abdulla Drenit. Kjo është marrëzi, verbim...

HOSHI I NURIT — (*Gati i déshpëruar.*) Hej, qoftë mallkuar kjo ditë e zezë! Qysh e paska nga tërruar në një lëmsh besën e pabesinë! Ditë tërbimi e pështjellimi, që na rrëmbejn me të drejtë dhe pa të drejtë në shakulli-

mën e vdekjes... Abdulla Drenit i kam shkuar gjithnjë si mik, bre burrë. Atij i paska zënë derën dashakeqi i Shqipërisë dhe ai e paska pritur si dashamir. Shaqir aga dhe Bajram aga i kanë dhënë besën mikut të tyre, si e lyp nderi i burrërisë. dhe unë i kam dhënë besën Bajram agës, si pas zakonit. S'kam si me kthye mbrapsht, jam burrë. (*Ul kryet e nuk flet më.*)

**PRENKË GULIA** — (*Ngrihet më këmbë.*) Tashti bjerë e fli, o krushku Hosh, je i lodhur. Nësër në mëngjes vjen Toni e bisedojmë me mendje të kthjellët. (*I thërret Mrikës.*) Moj nuse! (*Hyn Mrika.*) Shtroji vëllait me fjetë. Natën e mirë! (*Del.*)

**HOSHI I NURIT** — Natën e mirë!

### *Dukja 3*

*Hoshi i Nurit, Mrika.*

**MRIKA** — (*Shtron një dyshek për trolli.*) Si e ke nusen me shëndet, o vëlla?

**HOSHI I NURIT** — Prenda ka qenë mirë me shëndet, lavdi Zotit.

**MRIKA** — Po cullët, si i ke? Gjinin e Lulin? A janë rritë?

**HOSHI I NURIT** — I madhi ka nisë me përcjellë gjenë e gjallë në kullotë, i vogli sa u çua më këmbë.

**MRIKA** — Haj, i pastë emta!

**HOSHI I NURIT** — Po këta të tutë si janë? Dila sa vjeç u bë?

**MRIKA** — Shtatë, o im vëlla, një mot më e madhe se Gjini yt. Ka nisë me shkrua shqip. Si e sheh Toni e ka ngrehur mësonjëtoren shqipe

në kthinën e miqve. (*Tregon me dorë dërrasën e zezë.*) Këtu i shkruan shkronjat... Sikur ta kishe prurë Gjinin disa ditë te ne.

HOSHI I NURIT — (*Sikur kujtohet për diçka.*) Heu! Për pak harrova! Gjini më ka porositë me ju pru një dhanti Dilës. (*Merr nga trasta një fyell dhe i bie.*) E ka gdhendë me barinjtë, kur shkon me gjë...

MRIKA — I lumshin duart! Sa do gëzohet Dila!..

HOSHI I NURIT — Për Pashkun nuk kam ndonjë dhanti.

MRIKA — Pashku është i vocërr... Sa ka nisë me belbëzua: tata, nana... Thotë edhe daja...

HOSHI I NURIT — Hej llapushi dajës!... (*Shtrihet në shtrat.*) Shtambën dhe gotën m'a lerë këtu pranë. (*E motra ja avit pranë shtrojës.*)

MRIKA — (*Ndalet më gjunjë te kryet e të vëllait.*) Mirë të thotë tata. Qysh të vesh e të ngujo-hesh me zotnitë. Të vritesh për ta kot së koti. Mos e dhashtë zoti!... Po ti je i ri, o vëllai i motrës. Djemtë i ke të njomë, nusen e re, fillikat... Qysh do të gjallojnë pa ty... (*I vëllai ngrihet më gjunjë dhe e puth në ballë. Ajo shtang në vend.*) A ta fik dritëzën?

HOSHI I NURIT — Fike. (*Mrika fik dritëzën mbi vatër dhe del. Në kthinë hyn drita e hënës. Hoshi i Nurit përpëlitet në shtrat pastaj ngrihet më këmbë dhe vishet, ngjesh armët... Nis të zbardhëllojë. Së pratmi niset dhe del.*)

#### Dukja 4

Mrika vetëm, pastaj Prenkë Gulia, Toni i Prenkës dhe si prasmi Pater Pjetri.

MRIKA — (*Hyn me rrëmbim në kthinën e mique.*  
Në shtratin e zbrazët të vëllait ka rënë një  
rreze dielli, shkon te dritarja, në mesoren e  
djathtë, te dera e jashtme duke thirrur.)  
Hosh, Hosh, Hosh! Vëllai i motrës! (Në krye  
të shtratit ve duart në kokë e dëshpëruar dhe  
vajton.)

*Mjera u për ty, vëllai i motrës,*  
*Qysh t'ja lidh një rub' të zezë kokës!*  
*Mjera u për ty, vëllai i vetë,*  
*Qysh më ike, qysh më le të shkretë!*

Po kjo ikja jote është një punë e marrë, o  
vëllai i motrës! Ti po shkon vdekë për pa-  
shallarët, mor vëllai i motrës! (*Shembet në  
shtrat duke rënkuar.*)

PRENKË GULIA — (*Hyn në kthinën e mique i  
trembur.*) Moj nuse, shka të ka ndodhur? Pse  
vajton?

MRIKA — (*Duke treguar me dorë shtratin e të vë-  
llait.*) E si të mos qaj, mor tatë, Hoshi është  
ngritur herët në mëngjes dhe ka ikur...

PRENKË GULIA — Mos ndodhet në kurt të shtë-  
pisë?

MRIKA — Jo, mor tatë, unë që andej erdha. (*Për-  
plas shuplakët.*) Sikur të ma ndjente zem-  
ra se do të ikte kështu.

PRENKË GULIA — (*Me qëllim që t'i japë zemër.*)  
Mos ka shkuar diku në qytet, në kishë te Pa-  
ter Pjetri.

MRIKA — (*Me dëshpërim.*) Jo! Jo! E njoh unë t'imi  
vëlla.

PRENKË GULIA — Edhe në pastë shkuar në sara-

jet do të mundohemi me i nisë ndonjë fjalë prej Pater Pjetrit.

MRIKA — Kot, kot, kot!

PRENKË GULIA — Qysh kot. Ne nuk dijmë ende se çfarë rruge do të marrë kjo ngatërresë. Nuk është çudi t'i mbushet mendja Maxhar Pashës me u kthyesh mbrapsht në Stamboll.

MRIKA — Nuk i mbushet mendja atij qeni. E di unë, e di. Më fjalosi Toni para do ditësh. (Psherëtin.) Vërtet jam grua, por edhe unë kam nisë me marrë vesh se qysh janë nga-tërruar punët.

PRENKË GULIA — (Kërkon një shteg.) Heu! Edhe ti me fjalët e Tonit. Sipas tij duhet të kishin marrë flakë sarajet e Abdulla Drenit. Nuk është ashtu. Ne mund t'ja zgjatim edhe për herën e tretë besën të zot të shtëpisë. Do zoti i mbushet mendja dhe e përcjell mikun. Nuk e kemi këputur shpresat krejt. (Hyn Toni i armatosur.)

TONI I PRENKËS — (Duket mjaf i lodhur.) Mirë-dita, o tatë. Mirëdita, Mrikë. (Ve re sytë e përlotur të së shoqes dhe shqetësohet.) Shika ke që qan, moj Mrikë? (Ajo palos mbulesën dhe dënes.)

PRENKË GULIA — (E kap për krahu dhe e ul në një shkëmb.) Mbrëmë erди me bujtë te ne Hoshi i Nurit, vëllai i nuses... Por sot që-menatë shikoi në sarajet e Dullë Drenit.

TONI I PRENKËS — (I befasuar.) Dreqi ta marrë! Unë i çova fjalë deri në katund, që kur të vinte në Gjakovë të më takonte mua. Ai paska shkuar drejt e në saraje...

PRENKË GULIA — Dale, mor bir, mos u nxe! Ndoshta sillet aty rrotull kishës. Më thanë se edhe dje e kishin parë te kisha.

TONI I PRENKËS — Jo, mor tatë. Unë që andej po vij. Kemi zënë vend me fshatarët e Zymit.

PRENKË GULIA — Unë i çova fjalë qysh mbrëmë Pater Pjetrit. Desha ta syzoj (1) me Hoshin, se Bajram aga i paska thirrë fandët në emër të priftit. Ta dëgjonte me veshët e veta Hoshi i Nurit, se Bajram aga e ngatërron kot më kot Pater Pjetrin në këtë punë.

TONI I PRENKËS — E ngatërron kot a e ngatërron plot!

PRENKË GULIA — Qysh flet kështu, or bir?

TONI I PRENKËS — Ja, kështu: ne nuk dimë se shka foli Maxhar Pasha me Pater Pjetrin. (*Me një lëvizje të dorës që tregon mërzitje e keqardhje.*) Të mos e kishim lënë me shkua deri në sarajet...

PRENKË GULIA — Nuk kishim si e mbanim.

TONI I PRENKËS — Mirë Pater Pjetrin nuk kishim si e mbanim, por Hoshin si e latë. Ah, mor tatë! Po ti, moj Mrikë? Si e le Hoshin me ikë?

*(Mrika ul kryet e dënes.)*

PRENKË GULIA — Sa i kam folur, or Ton, nuk mund ta marrësh me mend. Ndejtëm deri vonë... Rashë të flej me shpresë se do të ndalej me të takua ty të nesërmët... Në mëngjes dëgjoj nusen që gjimon.

---

1) Syzoj = ballafaqoj.

**TONI I PRENKËS** — (*I padurueshëm.*) Dhe sa sa-  
hat besë kanë mbetur, or tatë?

**PRENKË GULIA** — (*Nxjerr sahatin dhe pasi e kë-  
qyr flet me dëshpërim.*) Dhe pak, shumë pak,  
o bir! (*Mrika rifillon të vajtojë.*)

**PATER PJETRI** — (*Hyn i habitur.*) Shka ka nusja  
që vajton?

**PRENKË GULIA** — Vajton të vëllanë, Hoshin e  
Nurit, që shikoi me u ngujua në trojet e Ab-  
dulla Drenit.

**PATER PJETRI** — Me e vajtua njeriun për së gjal-  
lli është mëkat.

**PRENKË GULIA** — Unë të çova fjalë me më ar-  
dhë në shtëpi qysh mbrëmë, o Patér Pjetri,  
kur Hoshi i Nurit ishte këtu. Pata shpresë  
se fjala jote do t'ja ndriçonte mendjen e mje-  
gulluar nga thashethemet. Prej tij dëgjova se  
fandët paskan zbritur në Gjakovë për t'i da-  
lë krah Maxhar Pashës me një fjalën tënde.

**PATER PJETRI** — (*Kundërshton.*) Me një fjalën  
time? Asnjë fjalë të këtillë nuk ka thënë go-  
ja ime. As Hoshi i Nurit e as fandët nuk ka-  
në ardhur në qytet me fjalën time. Ata janë  
miqtë e Abdulla pashë Drenit, ashtu si Sha-  
qir aga dhe Bajram aga me të tjerë. Unë nuk  
merrem me kësi punësh. E kam thënë edhe  
një herë tjetër: jam dorëjashtë.

**TONI I PRENKËS** — Edhe sikur të mos e kesh thë-  
në një fjalë të tillë, vajtja jote në sarajet i  
dha dorë Abdulla Drenit dhe Bajram agës  
me folë në emrin tënd. Heshtja jote...

**PRENKË GULIA** — Të thashë, o Pater Pjetri, se do  
t'ishte më mirë sikur të mos vije aq me ngut  
te sarajet...

**PATER PJETRI** — Nuk kisha si t'i bëja bisht një ftese nga i pari i vendit. Pastaj takimi ynë ishte aq i shkurtë: folëm gjermanisht, bëmë shaka me theksin tim vjenez, kur ja behën malësorët ashtu si tashmë e dini...

**TONI I PRENKËS** — Asnjeri nuk e beson se Maxhar Pasha të ka thirrë për mall të gjermanishtes.

**PATER PJETRI** — (*Rëndë-rëndë*.) Më kumtoi se Ku-vendi i Berlinit e miratoi autonominë e Mir-ditës.

**PRENKE GULIA** — Ne na duhet autonomia e Shqipërisë.

**PATER PJETRI** — Tashmë duket qartë se Turqia ka dalë në luftë të hapur kundër Itifakut të Prizrenit.

**TONI I PRENKËS** — Kjo luftë do ta bëjë Itifikun e myslimanëve Lidhje Shqiptare. Veza e gjelbër shpërtheu në Prizren e në Gjakovë... Prej saj dolën shlliga, si theshe ti, o Pater Pjetri, por shqiponja kastriote. Ato morën fluturimin në të katër anët e Shqipërisë: kah Mitrovica e Preveza, kah Janina dhe Ulqini që të ngrehin çerdhet e veta. (*Me keqardhje*.) Po ti nuک i sheh shqiponjat ashtu, si nuk e sheh as veten tënde. Mua më erdhi marrekur të pashë se qysh dole nga sarajet e Abdulla Drenit.

**PATER PJETRI** — Përse të vinte marre, unë nuk krevat ndonjë punë të papëlqyeshme.

**TONI I PRENKËS** — Pse dole *incognito*, veshur si malësor? Vetëm Pater Pjetri dhe Adjutanti i Sulltanit u detyruan me veshë petka malësorësh për me dalë nga rrithimi, do të thonë nesër.

PATER PJETRI — Ndryshe nuk mund të kaloje përmes turmës së përngritur të fanatikëve myslimanë...

TONI I PRENKËS — Ti u bashkove me fanatikët e vërtetë, që e luftojnë Lidhjen Shqiptare: me klerikët e lartë, myftinjtë, ylematë ashtu si u bashkove me Maxhar Pashën, Adjutantin e Sulltanit, Abdulla Drenin... Myderiz Ymer Prizreni, hoxhë Met Koronica, u treguan prijës të vërtetë të malësorëve dhe fusharakëve tanë. Pse të mos dilje edhe ti në krye të besnikëve të tu...

PATER PJETRI — Veshur me zhgunin e priftit, ngjeshur me armët e luftëtarit.

TONI I PRENKËS — Pse jo, si Pal Engjëlli, Pjetër Përlati...

PATER PJETRI — Po, po. Ty të ka joshur këto ditë hoxhë Ahmet Koronica me xhybe e me hutë, me divit e gjarpërushë; prijës i vegjelimit. Prandaj nuk i ndahesh nga Terzihana në Tegen e Sheshit, nga Mejtepi në Sheqerxhihanen e Sili Bagërit.

TONI I PRENKËS — Sa do të desha mos me u nda prej teje, o Pater Pjetri. Të kishe qenë dje në Zym i rrëthuar nga besnikët... Të vije me të shpejtë në Gjakovë dhe t'i mbidhje në kurtin e kishës fandët. «Bijtë e mij», t'u thoshe, «Marxhar Pasha s'është lëtin kryqali, por turk osmanlli, armik i shqiptarëve të krishterë e muhamedanë. Mos shkoni në sarajet e Abdulla Drenit, se ju kanë mashtruar». Ti heshte. I re këmbanës bëzëmbrëmje, besnikët u mblo-dhën me u lutë. Erdhën edhe fandët. Ti i be-

kove latinisht: Dominus vobiscum!<sup>1)</sup> Ata dolën nga kisha dhe vajtën me u ngujuua te Abdulla Dreni, Shika i lidhte fandët me parinë e pasur? Ofiqet në punët e shtetit, çifligjet?...

PATER PJETRI — E drejta me mbajtë armët dhe me dalë në luftë njënjë me parinë myslimanë, venomet e Mirditës katolike.

TONI I PRENKËS — Venomet e vërteta do t'ja japë Mirditës dhe gjithë Shqipërisë Lidhja Shqiptare.

PATER PJETRI — Ëndrra, ëndrra të marra, që ja u prishën mendjen juve dhe polemit. (*Fillohen të dëgjohen të shtëna*)

PRENKË GULIA — (*Nxjerr sahatin nga xhepi.*) Mbatoi besa!

(*Që matanë ndëgjohet përsëri vaji i Mrikës: Mjera u për ty!....»*)

PATER PJETRI — Ja ku e shputë vendin me këto ëndrra të marra...

TONI I PRENKËS — Po, ëndrra që kanë nisë me u sendërtua përmes këtij pështjellimi thirrjesh, krismash, gjëmësh, tym baroti... Ti nuk beson, ma ke thënë vetë. Je porsi shën Toma. (*Hedh pushkën më krah.*) Eja tashti edhe verë duart në varrët e luftëtarëve të Shqipërisë edhe shiko! Nga kurmet e tyre nuk rrjedh gjaku cirka-cirka, por shkulma-shkulma. Kështu ke përtë besuar... Por në daç të shpëlash duart me një shtambë ujë si Pilati, për t'u shfajësuar, ti s'ke përtë shpëtuar. Ato duar nuk i shpëlan as Drini në buenë. (*Del.*)

---

1) Zoti goftë me ju (latinisht)

## VEPRIMI V

A. Pamja nga rruga.

Te lisi i rrëzuar përdhe:

Dukja 1.

*Mic Sokoli, Malësori I, Malësori II, Malësori III, Malësori IV, Shpendi, Bozaxhiu, Ganiu, Mujë Muhaxhiri e të tjerë.*

MIC SOKOLI — (Ka venë dorën mbi sytë strehë dhe shikon larg.) Burra, zini vend të gjithë përmbi udhë. Tabori s'është larg.

MALEËSORI I — (*Hyn me rrëmbim.*) O Mic Sokoli, Lam Batusha me çon te ty: të ngajuarit në saraje kërkojnë besë pér të mbushur ujë te Përroi.

MIC SOKOLI — (*Duke kthyer kokën.*) Tri herë besë u kemi dhënë. Dhe pas çdo bese ata na kanë vrarë përsëri. Besë pér ta nuk ka. Kështu ka dhënë urdhër Sulë Vokshi. (*Shikon përsëri larg.*) Shko i thuaj Lam Batushës. (*Malësori del.*)

MALEËSORI II — A duket gjë, o Mic Sokoli?

MIC SOKOLI — Asgjë veç një tymi të lehtë, o Sulë Potera.

**MALËSORI III** — (*Hyn me rrëmbim.*) Ali Ibra më çon te ty, o Mic Sokoli. Kerret me bar të tha-të i qasëm te Përroni. Edhe shkallët e gjata i kemi gati.

**MIC SOKOLI** — (*Kthen kryet.*) Vajgurin a e gjetët?

**MALËSORI III** — Nisëm trimat me e mbledhë shtëpi më shtëpi me teneqe në dorë.

**MIC SOKOLI** — I thuaj Ali Ibrit të na presë. Tabori nuk po duket. (*Malësori III del. Mic Sokoli i lëviz dorën për të parë më mirë.*)

**MALËSORI II** — A shikon gjë, o Mic Sokoli?

**MIC SOKOLI** — Një tym... Një kalorës. Po, ai duhet të jetë domosdo: Col Delia. Burra, a merrni vesh se po vjen tabori... (*Dëgjohet troku i një kali,*)

**MALËSORI II** — Po, pasha dheun! Ja behu Col Delia mbi kalë.

**MALËSORI IV** — (*Hyn duke marrë frysë thellë.*) Po vijnë ngadalë, mos kini drojë! Janë të gjithë në këmbë.

**MIC SOKOLI** — Shumë mirë, o Col Delia.

**SHPENDI** — A kishin martina, o Col Delia.

**MIC SOKOLI** — Mos kij dert, o Shpend Hekakeqi: ushtarët e mbretit janë të gjithë me martina.

**BOZAXHIU** — A nuk të thashë unë!

**GANIU** — E ku ta dinte Shpend Hekakeqi se ti paske qenë dhe i ibrikut me bozë, dhe i martinës me lloz.

**SHPENDI** — Se mos Sili Bozaxhiu e ka martinë, hутën që mban në krah. Edhe ai karajfile e ka si unë.

**BOZAXHIU** — Karajfile e kam, po këtu në fushën e Bajram Pashës do ta bëj martinë.

**MALËSORI II** — (*Merr karajfilen e Shpendit në do-*

rë.) Këto karajfile janë armë për trima: ti e mbush me këmbë dhe ai kundërshtari të qëllon. Martinat janë armë për tutsa. (*Malësorët qeshin.*)

MIC SOKOLI — Kurse armët për trimat e vërtetë janë jatagani e topuzi.

MALESORI II — E ka thënë gjeto Basho Muji.

SHFENDI — Por edhe ti, o Sulë Potera, paske një martinë belike...

MALESORI II — E kam martinë vendi, punuar nga Bajram Gorgonica, në Tetovë, hutë shqiptare. (*Përsëri qeshin.*)

MIC SOKOLI — Tashti nisu kah sarajet e Abdulla Drenit, o Sul Potera, bashkë me Col Delinë, se ty të takon prija në mësymje. (*Del Malësori II e Malësori IV.*) Burra, mbushni hutat dhe zini vend që të mos dukeni nga udha. Asnjeri të mos shtjerë pa urdhërin tim! Do të rrekemi me u marrë vesh. Ndoshta midis tyre ka edhe shqiptarë. (*Të gjithë tërhiqen nga skena.*)

## Dukja 2

Ushtari I, Ushtari II, Ushtari III, Ushtari IV dhe të tjera hyjnë në skenë të lodhur, të djer-situr...

USHTARI I — Na mbyti vapa.

USHTARI II — Na kapiti rruga; që nga Mitrovica deri në Gjakovë është goxha rrugë e gjatë. (*Dëgjohet larg ndonjë pushkë e rrallë,*)

USHTARI III — (*I habitur.*) Ore shokë, pa dëgjoni: këtej u bëka luftë.

MIC SOKOLI — (*Hyn te lisi.*) Me ngadalë t'ju them një fjalë, o askerët e mbretit: A ka shqiptarë mes jush?

**USHTARI I** — Ne shqiptarë jemi, o burri i dheut!  
*(Hijnë malësorët.)*

**MIC SOKOLI** — E ku po shkoni?

**USHTARI II** — Këtu, në Gjakovë, na kanë dhënë urdhër.

**MIC SOKOLI** — Po a e dini përse ju kanë nisur për në Gjakovë?

**USHTARI III** — Qe tashti po e marrim vesh se u bë-ka luftë...

**MIC SOKOLI** — Ju kanë nisur për të luftuar me tri-  
mat e Lidhjes Shqiptare.

**USHTARI III** — Shka je kah flet, bre burrë: ne vë-  
lla me vëlla, nuk luftojmë. (*Hedh pushkën përdhe.*)

**USHTARI I** — Ne jemi shqiptarë.

**MIC SOKOLI** — (*Bën lësa hapa dhe e përqafon Ush-  
tarin III.*) Të lumtë goja, o vëlla, (*Malësorët  
përqafohen, tokin duart. Disd ushtarë zhve-  
shin petkat ushtarake. Shpend Hekakeqi shkon  
e merr martinën, që ka hedhur përdhe Ushta-  
ri III. Bozaxhiu i përkëdhel armën Ushtarit  
II. Ai ja len në dorë. Bozaxhiu i gjuar i lëvdo-  
het Shpendit; ai i tregon përpëra armën e vet  
të re. Në këtë rrëmujë hyn përsëri Malësori  
IV.*)

### Dukja 3

Të parët dhe Sulë Vokshi, Toni i Prenkës, Met  
Koronica, Malësori V, Ali Gucia, Hasan Batu-  
sha e të tjera.

**MALESORI V** — (*Hyn me rrëmbim.*) Po vjen Sulë  
Vokshi, po vjen Sulë Vokshi! (*Të gjithë drej-  
tohen nga i porsaardhuri.*)

**SUL VOKSHI** — (*Duke hyrë.*) A jeni burra!

**MALESORË DHE USHTARE** — Të paçim me nder,  
o Sulë Vokshi!

**MIC SOKOLI** — Si e sheh, o kryetari ynë, tabori i Mirtovicës u dorëzua. Kur e morën vesh ushtarët se i kishin nisë me u vra vëlla me vëlla, i hollët armët vetë dhe u bashkuan me ne.

**SUL VOKSHI** — Ju lumtë, o molësorë! Ju lumtë, o ushtarë! Vetëm kështu, të bashkuar, do t'i bëjmë ballë rrezikut të zi, që na lëshoi mbi krye Evropa. Vetëm kështu, të bashkuar, do t'i ruanjmë trojet tona të plota, ashtu si na i lanë të parët. (*Ndryshon tonin.*) Na duam të jetojmë në Shqipëri të lirë, në miqësi të mirë me fqinjët dhe me botën. Por Kralitë e Mëdha e quajnë vendin tonë truall të shkretë, pa zot. Dhe Mbretëria e Stambollës kërkon të mbahet duke ndarë trupin e Shqipërisë copa-copa. Për këtë gjëmë e lidhëm besën shqiptare në Prizren. Shqipëria ka zot, nga trojet tona nuk lëshojmë asnjë pëllëmbë. Ky është betimi ynë, besa jonë e madhe që do të na mbajë më këmbë... Abdulla pashë Dreni me miqtë e tij, duke marrë në ndore Maxhar Pashën, të dërguarin e mbretit, na u shpabesën. Ata u ngujuan duke i dhënë njeri-tjetrit besën. Por qdo besë që bie ndesh me besën e Shqipërisë, është pabesi. Kështu vendosën në Gjakovë luftëtarët e Lidhjes Shqiptare, vegjëlimi. Të marrin vesh edhe krerët e parësimit, që mbahen dorëjashtë... (*Hijnë Ali Gucia, Hasan Batusha.*)

**ALI GUCIA** — (*Duke hyrë.*) Jo të gjithë krerët e parisë kanë mbetur dorëjashtë. Ka edhe krerë që, për të mbrojtur trojet e të parëve, u bashkuan me vegjëlimin, o Sulejman agë Vokshi.

**SULË VOKSHI** — Ashtu është, Ali Pashë Gucia. Ti je ndër ata pashallarë që e duan Shqipërinë.

**ALI GUCIA** — Unë jam nga ata që i vunë themelin Lidhjes Shqiptare, në Prizren. Kjo është rruga e nderit tonë. Shi për këtë nder zbrita me mbledhë vullnetarë në Rrafsh, i hodha përdhe nishanet dhe tujet e mbretit në sarajet e Abdulla pashë Drenit dhe u bashkova me milletin. A nuk është kështu, o Hasan agë Batusha?

**HASAN BATUŠA** — Kështu është, o Ali pashë Gucia. E bore fora...

**ALI GUCIA** — Një herë kemi me vdekë, atëherë le të vdesim si burrat. (*Me keqardhje.*) Vetëm më vjen keq për ata njerëzit tanë, që u ngujuan me Mehmet Ali Pashë Maxharin, mynafikun<sup>1</sup> e Lidhjes...

**MET KORONICA** — Edhe dora, edhe këmba është e jona, por kur e merr plumbi dhe ajo e mban në mish të saj, ne qëllojmë në dorën, në këmbën tonë plumbin me plumb. Kështu e djegim helmin e armikut në plagë dhe e dlim trupin nga praja.<sup>2</sup> (*Të gjithëve.*) Të lidhim besën, o burra! Asnjë tradhtar të mos dalë i gjallë nga sarajet. Rruga jonë për në Plavë e në Guci shkon nëpër sarajet e Abdulla Drenit. Fjalë-fjalë e besa-besë!

**TË GJITHË** — Besa-besë!

**MIC SOKOLI** — (*I afrohet Ali Gucisë.*) Ja ku japim fjalën e burrave, o Ali pashë Gucia: sa të laj-

---

1) mynafiku — intriganti

2) praja — infekzioni

më hësabet me Maxharë, vrik e në kufi te ty  
do ta ndalim ëryshin. Veç duro e mbahu një  
javë, sa të presë e thurë opangat fukaraja, se  
ky Maxhar Pashë erdh papritur edhe kemi  
zbritur mbathë e zbathë... (*Ali Pashë Gucia e*  
*përqafon.*)

**SUL VOKSHI** — Të lumtë goja, o Mic Sokoli, trojet  
tona armikut s'kemi më ia lënë pa i mbushë  
me vorre anë më anë.

**MIC SOKOLI** — (*I afrohet Tonit të Prenkës.*) Tashti,  
o mësuesi i çunave na thuaj atë këngën e Pa-  
shko Vasës e pastaj t'ja nisim sulmit mbi sa-  
rajet.

**MET KORONICA** — Thuaja ta dëgjojë Rrafshi i Du-  
kagjinit e gjithë Kosova, se për këtë ditë të  
sotme e shkroi Pashko Vasa.

**TONI I PRENKËS** — (*I prekur.*)

*O moj Shqypni, e mjera shqypni.*

*Kush të ka qitë me krye në hi,*

*Ti ke pasë kenë nji zojë e randë,*

*Burrat e dheut të thirrshin nanë...*

*Por sot, Shqypni, më thuaj si je?*

*Porsi lisi i rrëzuem përdhë;*

*Shkon bota sipri më këmbë të shklet*

*E një fjale t'ambël kurrkush s'ta flet.*

*Kujt i ban zemra me lanë me dekë*

*Këtë farë trimëneshe që sot asht mekë,*

*Këtë nanë të dashtun a do ta lamë*

*Që njeri i huej ta shklasë me kambë.*

*Nuk, nuk! Kët' marre askush s'e do  
Kët' faqe të zezë gjithkush e dro.  
Para se të hupet kështu Shqipnia  
Me pushkë në dorë le t'desi trimnia.*

### **MIC SOKOLI — (I papërmabajtur.)**

*Çoniu shqiptarë, prej gjumit çoniu,  
Të gjithë si vllazën në i besë shtrëngoniu!*

**TE GJITHE — Para se të hupet kështu Shqipnia  
Me pushkë në dorë le të desi trimnia!**

**SUL VOKSHI — Na qoftë kjo fjala e Pashko Vasës  
këngë majekrahut, piskamë e batare push-  
kësh. Përpara, o burra!**

*(Dalin..)*

**C. Pamje nga sarajet e Abdulla Drenit. Kona-  
ku i miqve.**

### **Dukja 1**

*Abdulla Dreni, Shaqir Aga, Bajram Aga, Ho-  
shi i Nurit qëndrojnë në divan gjysmë shtrirë  
edhe përtrolli, armët i kanë pranë. Dëgjohet  
një krisëm e rrallë. Më vonë Hanmi i Pashës,  
Mehmet Ali Dreni.*

**ABDULLA DRENI — (Me kryet varur përdhë.) Be-  
sën që kërkua për ujë nuk na e dhanë... Edhe  
trimat që dërguam natën nëpër terr te Pérro-  
ni nuk u kthyen.**

**BAJRAM AGA — Mbëtën atje.**

**SHAQIR AGA — ... Ose kaluan matanë. Na u dogj  
shpirti për ujë...**

**HOSHI I NURIT** — Gushti i sivjetëm ishte i thatë.  
Dy herë e kam ujitur kallamboqin. Desha t'i fut ujët edhe një herë të tretë, por erdh lajmësi yt, o Bajram Aga. Nuk pata kohë. Edhe vjeshta e parë nisi e thatë. Kush e di si do të jetë vyshkur në këto ditë vape e thatësie. Kalliri do të mbetet i vogël, pa bukë. Ujët është jetë...

**SHAQIR AGA** — Thatësia është vdekje. Ne po thahem, po vdesim ngadalë.

**HOSHI I NURIT** — Njeriu dalka mendsh prej etjes, or burra. Shka më ndodhi mbrëmë me trimat e Fandës. Tek bartnin disa shokë me varra, njerit prej trimave iu imbushtën grushtat me gjak. I afroi te buzët dhe desh me pi.

**SHAQIR AGA** — Gjak?

**HOSHI I NURIT** — Po gjak. Por gjaku nuk ta shuan dot etjen. Sikur pi shëllirë...

*(Hanmi i Pashës hyn nga dera e brendshme në konakun e mijve.)*

**ABDULLA DRENI** — Pse ke dalë nga haremi?

**HANMI I PASHËS** — Po kérkoj çunin.

*(Mehmet Ali Dreni zbret nga shkallët me një dorë pas shpine.)*

**ABDULLA DRENI** — (I bën me dorë.) Ja tek e ke.

(Të birit.) Shka po mësheh ashtu, o Mehmet Ali?

**MEHMET ALI DRENI** — Asgjë, babë, një kokërr dardhë.

**ABDULLA DRENI** — Si nuk ke marre, or bir. Ne ja kemi lënë mikut ato dardha. A merr vesh se qysh tri ditë na ka rrëthuar mileti dhe ne po luftojmë për këtë mik. Kemi tri ditë që

luftojmë me plumbat, me urinë, me etjen. Qëndrojmö e mikun nuk e lëshojmë. Më mirë me vdekë si burrat, se me çartë besën. Edhe ti vete i vjedh dardhën e fundit.

**MEHMET ALI DRENI** — (*Kundërshton e kafshon dardhën.*) Pse nxehesh, o babë, unë vetë i mblohdha dardhat përmes plumbave.

**ABDULLA DRENI** — E mandej... Të koritemi për një dardhë. Miku është mik.

**MEHMET ALI DRENI** — Miku është mik për ne, por për ata është arniq. Dhe nuk e kane keq. Sa shkeli në Kosovë, na vuri pishën, na dogji për ujë. Unë dua ujë, nuk duroj dot.

**ABDULLA DRENI** — (*I zemëruar ngrihet në këmbë.*) Edhe ti të ma thuash këtë fjalë. Unë po vritem, po vdes këtu për një ndër. Mos të ta le një vregën,<sup>1)</sup> mos të të thotë kush se ty të ka koritë baba; ti më thua se u dogja për ujë. Hiqmu prej sysh, o bimë e keqe. Mos të të shoh më. S'je nga gjaku i Drenajve të Gjakovës, ti je nga qumështi i Bogollajve të Pejës.

**HANMI I PASHËS** — (*E merr nën mbrojtje të birin.*) Mos ma shaj çunin për një kokërr dardhë, o burri. Është i njomë e nuk duron si të rriturit. Mjaft më. A nuk e shikon se ku na fute! ... Vetë i ke fajet. Kot i përgojon edhe njérëzit e mi...

**ABDULLA DRENI** — (*Me mllef.*) Ata njerëzit e tu ma lanë kopil nië derë Mehmet Ali Pashën.

**HANMI I PASHËS** — (*Pa u tërhequr.*) Mua nuk ma mbush mendjen. Mehmet Ali Pashë Maxharin nuk ta la kush në derë ty. E ke pasur mik

1) Vregë — njollë.

të zemrës që kur ishe i ri në ushtrinë e mbretit. E kënduar si pejkamber. Ndryshe nuk ja vije emrin djalit Mehmet Ali. Kujtohu mësore e mos i a hidh fajin parësimit të Pejës. Ata nuk e morën në ndore të dërguarin e mbretit, se u trëmbejn nga Haxhi Zeka e vegjelimi. Ti dole trim dhe na e prure në shtëpi. Mbaje tashti e mos u tut.

**ABDULLA DRENI** — Unë nuk tutem dha e mbaj, mua më thonë Abdulla Dreni. Unë nuk tuntem as nga Sulë Vokshi, Haxhi Zeka dha poshtë lemi. Merre çunin e myllu në harem. Atje e keni vendin.

**HANMI I PASHËS** — (Të birit.) Të shkojmë, o bir, dhe të durojmë. Për mikun të zë nderi, të ze edhe qederi. Të mirat e pashallékut i shijuam, t'i shijojmë tashti edhe jë këqiat. (Dalin.)

**Dukja:** 25. Nëntor 1942. Në këtë ditë, 25. Nëntor 1942.  
*Abdulla Dreni, Shaqir Aga, Bajram Aga, Hoshi i Nurit.*

**ABDULLA DRENI** — (I zemieruar.) Në këtë të keqë të madhe edhe gruaja edhe evlati m'u shpabesëni; pa le miqtë e dashmirësit.

**SHAQIR AGA** — (Rreket ta qetësojë.) Mos e prish gjakun, grua është.

**BAJRAM AGA** — Edhe cuni është i njomë, Abdulla pashë Dreni, se di, aq iu zemëro.

**HOSHI I NURIT** — Për miq e dashmirë të tjerë, nuk dijmë shka me të thanë. Në të kemi pasur mik e do të kemi mik deri sa të vdesim.

**ABDULLA DRENI** — Hej sa miq ka pritë e ka përcjellë ky konaku im, o burrat e dheut. Disa

prej tyre ishin këtu deri përpara pak ditësh. Me të krisur huta u bënë def. Ikën me nga një mëtim;<sup>1)</sup> me një përemtim e s'u kthyen më. Edhe ai sejmeni im, Masar Aga, një hiç prej hiçi, që e bëra njeri, iku dhe më la vetëm. Sa ndere e përfati<sup>(2)</sup> ka bërë ky Abdulla Dreni, ju nuk e dini... Edhe ato shkuan kot.

SHAQIR AGA — Ata ishin miq pér fiq.

ABDULLA DRENI — Unë desha t'i kisha sot... Nga téré ajo mori me lajkatarë dhe puthadorë vetëm ju më mbetët miq të vërtetë, miq të besës.

Ju qofsha falë sé nuk ma thyet zemrën. (*I kap pér supash Shaqir agën dhe Bajram agën.*) Tani të pajtohemë këtu në konak të mikut tuaj, HOSHI I NURIT — Bukur mirë e ke thënë këtë fjalë, o Abdulla Dreni.

SHAQIR AGA — Hej, or burra, unë erdha në këtë konak me pajtua Abdulla pashë Drenin me krerët e polemit. Kjo ishte hasmëria e madhe. Hasmëria ime me Bajram agën nuk prishtë punë.

BAJRAM AGA — Ne qyshkur erdhëm në konakun tünd...

ABDULLA DRENI — (*Shaqir Agës.*) Mos ma thyej zemrën...

SHAQIR AGA — (*Me dëshpërim.*) Unë e kam zemrën copë, ndarë më dysh; gjysmën e kam matanë Përronit me bajrakun, dhe gjysmën në këtë anë të Përronit, në konakun tünd. As dheu nuk do të më tretë.

(*Dëgjohet një batare pushkësh dhe brohorin*)

1) Mëtim — pretendim

2) Përfati — gosti

**Dukja** — (Tjetë tje.) Maxhar Pashë zbret i shkallët i lligshtuar dhe i trembur.

**Dukja** — (Tjetë tje.) Dukja, o mësues, shtatë.

**Abdulla Dreni, Shaqir Aga, Bajram Aga, Hoshi i Nurit, Maxhar Pasha.**

**MAXHAR PASHA** — Jemi keq, o miqtë e mi. Tash-tarët e ndjej se jemi keq me të vërtetë. Kryengri-tësít hynë në kazermat e taborit. Askerët i ushqinë brekët dhë i nisen përmes ikasabasë. Ushqinë tarët e mbretit zhveshur me brekët e me kë-mishët. Qamet! Tashti mbetëm vetëm, mbetëm keq!

**SHAQIR AGA** — E kur paskemi qenë mirë?! Kemi tri ditë e tri net që luftojmë pa bukë e pa ujë.

**BAJRAM AGA** — Dhe do të luftojmë derisa të na rëf-këtijë gjaku ndër deju.

**ABDULLA DRENI** — (Merr Maxhar Pashën përkrahut dhe e ul në divan përzemërsisht.) Rri këtu! Kemi edhe të tjere trima që n'a mbrojnë. Ti mos kij drojë sa jemi gjallë ne! Nuk të gjën asgjë e këqe! (Hoshit të Nurit i është dorëndësi.) O Hoshi i Nurit, më trimat e Fandës hip në kullën matanë dhe mbrona konakun nga malësorët. Mos na hyjnë këtu brënda papritur.

**HOSHI I NURIT** — (Merr pushkën në dorë.) Atë punë e kam në dorë vetë, o Abdulla pashë Drëni.

(Del. "Dëgjohen disa të shtëna të forta, pastaj qetesi.)

**ABDULLA DRENI** — Hej, të lumtë dora, o Hoshi i Nurit!... Këta trimat e Fandës ma zbardhën faqen, or miqtë e mi.

**MAXHAR PASHA** — (Sikur bisëdon me vëtveten.)

Kjo është kryengritje, kryengritje e mitletit. Ashtu si në Evropë, në Paris, harbutët e pabukë, zanatçinjtë shtrembalakë, bakallët ziliqarë, fshatarët morramanë, malësorët e pagdhendur: turma më xhahilë të thërret, të shan, të vret... Dhe paria e sojllinjve të qullët hap udhë, nguron të godasë me grushtin e hekurt të dhunës të përngriturit, krenëzit e vegjelisë, fundërrisë. Dhe bëhet ashtu si thonë, si klithin kryengritësit; fisnikët në qenef, në satër, në varr! Vettëm ti, Perandori Otomane, kishe mbetur e paprekur nga kjo lëngatë, murtajë, tèrbimi i mitletit. Ishte xheneti ynë mbi dhe, por papritmas në një muarrebe na u bë xhenem. Si mjerë ne! Jemi në mëshirë të mitletit. As vilajeti, as dovleti, nuk na shpëton. Medet! Allah selamet! (Ngre duart, përpjetë duke u falur dhe ngjitet përpjetë shkallëve.)

**ABDULLA DRENI** — (*Rrëmben pushkën dhe zë frëngjinë.*) Ne, nuk do të dorëzohemi si fisnikët e Evropës, o Mehmet Ali Pashë, as si ata asqet rët anadollakë, që i vunë përpara në brekët e në këmishët. Të gjallë nuk jepemi! Do ta sheshim lëkurën shumë shtrenjti! (Qëllon disa herë, Nga dera e brendshme hyn Hanmi i Pashës, me Mehmet Ali Drenin për krahu.)

#### Dukja 4

Abdulla Dreni, Shaqiraga, Bajramaga, Mazzhar Pasha, Hanmi i Pashës, Mehmet Ali Drenini, Malësoni Fandë Pas, të shtënave të prasme në konak është qetësi. Kjo qetësi prishet nga zhurma e një gjymi, kove të zbrazët që godasin me këmbë të porsaardhurit.

**ABDULLA DRENI** — (I shqetësuar.) Po ju? Shka doni këtu?

**MEHMET ALI DRENI** — (I këputur.) Uje, uje, ujë! (Rrëzohet në divan.)

**HANMI I PASHËS** — (E trembur.) Në konakun tonë nuk mundëm me qëndrua më gjatë. Në hypën malësorët mbi pullaz dhe na vunë zjarrin. Na verboi tymi, na mori frymën!

**ABDULLA DRENI** — Po hyzmeqarët ku vanë?

**HANMI I PASHËS** — Hyzmeqarët! Ca u vranë, ca morën arratinë nëpër tym e flakë. Vetëm ne mbërritëm këtu të gjallë, duke shkelur mbi të vrarët dhe të plagosurit në oborr.

**ABDULLA DRENI** — (I befasuar!) Shka je kah thua, moj grua!

**HANMI I PASHËS** — Qe kështu si të them unë ësh-të puna: jemi në buzë të grëminës. Pá nxirri një shami të bardhë në dritare dhë lyp besë pér djalin dhe pér mua.

**ABDULLA DRENI** — (Ngurron.) Tri herë kam lypur, besë dhe mleti ma ka dhënë, pér të katërtën herë nuk lyp, se kam marre. Ta dij se vdes që tashti. Ku të vdes unë, vdes edhe ti me djalë.

**HANMI I PASHËS** — (E zemëruar sa s'ka.) Ti ke dali mendsh, or burrë. Qysh të vdesë diali!

**MEHMET ALI DRENI** — (Si në jerm.) Unë do të vdes pér ujë. Unë po vdes pér ujë... (Qetësi. Dëgjohet fërshëllimë e shkurtër e disa plumbave, që ngulen në mur, brenda konakut. Abdulla Dreni shqetësohet dhe shtje sytë nga derë e brendshme, ku hyn malësori fand.)

**ABDULLA DRENI** — (Niset kah dera e brendshmë.) Shka ka Fanda që u shurdhua, bre burra?

**MALESORI FAND** — U varrua Hoshiki Nurit, o Abdulla pashë Dreni.

**ABDULLA DRENI** — Qëndroni si trimaf, o djemtë e Fandës. Gajret! (Del nga dera e brendshme. Bajram Aga i bie pas, Shaqir Aga ruan i frënë gjitë e jashtme me dyfek në dorë, ndërsa Maxhar Pasha zbret përsëri.)

**MEHMET ALI DRENI** — (Me dëshpërim.) Ah, moj nënë, imatë i ka dhënë besën Maxhar Rashiës, prandaj do të bëjë kurban veten e vet, djalin, gruan, shtepitë... Unë do të vdisja që tashti i lumtur, vetëm të ngopesha njëherë me ujë. Ujë, ujë, ujë! Përroni rrjedh ujë të kulluar, gungullon: glu, glu, glu!... Tërë natën nuk më ka zënë gjumi nga gurgullima e ujit: glu, glu, glu!.. (Ngrihet më këmbë dhe drejtohet kahëdëra e jashtme. Shaqir Aga nuk e vë re.) Do të hidhem nga dritaret të Përroni. Nuk mund të duroj më. Më mirë vdes prej plumbit, se prej etjes.

**HANMI I PASHËS** — (Përpinqet ta përbajë.) Qyqja, çuni!... (Pengohet pas një kove bosh dhe rrëzohet.) Mos, Mehmet Ali, se do të të vrasin. (Në këtë kohë Maxhar Pasha zbret poshtë dhe kthen kryet i habitur të shohë çfarë po ndodh. Bajram Aga hyn nga dera e brendshme dhe i turret pas Mehmet Ali Drenit që ka dalë jashtë. Malesori fand pas tij.)

**BAJRAM AGA** — (Me dëshpërim.) Ku vete, or çun! (Del. Qetësi. Dëgjohet një zë që jashtë. «Prite, prite, o Bajram aga!» Dhe një e shtënë pushke, pastaj një rënkim! «Ah!» Qetësi.)

**SHAQIR AGA** — (Lëshon pushkën nga dora.) E vranë edhe Bajram Agën. (Niset të dalë jashtë.

*Te dera e jashtme takohet me malësorin fand, i cili po sjell Bajram Agën e plagosur. Ndër-kohë nga dera e brendshme hyn Abdulla Dreni. Dy të parët e shtrijnë në divan Bajram Agën që vdes menjëherë. Mehmet Ali Dreni hyn me sytë të zgjurdulluar nga tmerri.)*

**ABDULLA DRENI** — (Shikon rreth e qark i hutuar.)  
Shka ndodhi?

**HANMI I PASHËS** — (Mezi mbahet më këmbë.) Çuni

ku nis kah Përroi...

**ABDULLA DRENI** — (Me habi dhe hidhërim.) Na  
e vranë Bajram Agën, mikun e besës! (Mehmet  
Ali Drenit.) Që! Ata miqtë e tu na e vranë.

Ata na e vranë Bajram agën, Hoshin e Nurit!

**MEHMET ALI DRENI** — (Flet si në kallapi.) Shqip-  
tarë me villazën jeni t'u vra... kam fe... din, din,  
dini, din! (Ec si i dehur, pastaj rrëzohet pranë  
Hanmit të Pashës duke bëlbëzuar.)

**HANMI I PASHËS** — Ah, unë e mjera, më doli  
mendsh djali...

**SHAQIR AGA** — Të gjithë ne kemi dalë mendsh,

Hañmi i Pashës...

**MAXHAR PASHA** — (Urdhëron me dörë malësorin  
fand.) Bjermë këtu një kovë ujë!

**SHAQIR AGA** — (Me habi dhe keqardhje.) Edhe ky  
nuk është ndërmend. Ku ta gjejmë kovën  
me ujë! Na po vritemi pér një pikë ujë.

**ABDULLA DRENI** — Mehmet Ali Pasha kënkon një  
kovë cuji të zbrazët. (Malësori fand merr nji  
kovë uji dhë ja çon përparrë Maxhar Pashës.)

**MAXHAR PASHA** — (Merr një trastë, që ka pranë  
dhë e derdh, në kovë.) Këtu janë gjashtë mijë  
grosh. Kush është i zoti të ma sjellë plot me  
ujë, ja kam falur (I tregon malësorit fand.) Një

kovë me flori pér një kovë ujë! (Malësori Fand e ngurron pér tē marrë kovën.) Në qoftë se asnjëri prej jush nuk guxon, u kërkoni besë kryengritësve dhe ja u lëshoni me litar nga dritarja: një kovë ujë pér një kovë flori. (Malësori fand e merr kovën dhe del. Qetësi. Dëgjohet një zë që bërtet nga brendësi. «Besa-besë!» Qetësi. «Besa-besë!» Maxhar Pasha ju dërgon një kovë me flori pér një kovë ujë! Maxhar Pasha ju kërkon një kovë ujë pér një kovë me flori!» Që jashtë përgjigjet një zë: «Ujët e krojeve tonë nuk blihet me flori!» Gërvima e çikrikut. Malësori fand kthehet me kovën në dorë te Maxhar Pasha.)

**MALESORI FAND** — Asnjeri nuk e preku me dorë. (Lëshon kovën përdhe dhesë del.)

**MAXHAR PASHA** — (Me kovën në dorë.) Gjashtëmi-jë grosh një kovë ujë. Kurrë ndonjëherë nuk ka kushtuar kaq shtronjtë ujët. Një kovë ujë pér një kovë me flori... Por floririle paska humbur vlerën në këtë vend. Asnjeri nuk e prek me dorë. Asnjeri nuk e lakmon. Më duket si çudi. Unë jam djegur tërë jetën time pér flori, ashtu si digjem sot pér ujë. Flori, fuqi... Fuqi, flori... (Mbush grushtin me flori.) Sa më kenë ni joshur në jetë nga Magdeburgu në Stamboll. Dhe tashti së prami zyra e ministrit, e vezirit, çifliku i bukur buzë dëtit. Qyshi më humbën papititur nga Prizreni në Gjakovë. Medet!... Jo, jo, jo! Nuk është e mundur që floriri ta ketë humbur vlerën. Ata që në rrethojnë janë të qëmendur, janë tërbuar... (E shtje floririn në trastë përsëri duke shikuar rrëth e rrrotull me drojtje.)

**SHAQIR AGA** — (*Mezi mbahet më këmbë, por të mire mllef.*) Të tèrbuarit nuk janë ata jashtë, jemi ne tèreturit pér ujë, ne që ulemi, të shumajmë etjen në pellgjet e gjakut, në plagët e shokëve dhe pijmë, por etjen nuk e shuajmë dot... (*Rrëzohet pranë Bajram Agës e ngrihet më gjunjë përsëri.*) Unë, nuk do të pij gjakun tënd, o Bajram aga; gjaku ynë është i njel-mët, i helmët. Nje ky, i dërguari i mbretit, erdhi si qen, i tèrbuar nga Stambolli dhe na kafshoi në besët, na helmoi, na tèrboi. Në jetëmji të tèrbuar, prandaj na ngujuan në këto saraje derisa të vdesim, që të mos kafshojmë të tjerë... (*Ngrihet më këmbë.*) Dhe kështu mbylljet jeta jone andrallë dhe bëhet pér ata që që të vijnë përrallë: «Të mos e jepin besën e shqiptarit pa e peshuar në të mirë e nér të liq, nér mlq' e armiq. Dhe ai që dò tu troksë në derë, ta ketë zemrën e dlitë, përndryshe do ta pësojë si Maxhar Pasha dhe ata që i vari pas Seändera lypur është besa lyp i tashë besës!» (*Rrëzohet përdhë i këputur.*)

**MAXHAR PASHA** — (*Niset nga dera e jashtme.*) Eshtë e kujtë të qëndrojimë në konakun tënd, o Abdulla pashë Dreni. Ju mora, më qafë. Unë do të dalë me u dorëzua te kryengritësit që të shpëtoni ju. Të më ndodhë shka të më ndodhë, ky paska qenë takriratë im.

**ABDULLA DRENI** — (*I del përparë.*) Mbahu, burrë, Mehmet Ali pashë! Mos shko si çjapi te kasapi; ata do të vrasin sa te hapësh derën. Ta kishe patur këtë mendje, që në fillim, të përcillja vetë sipas kanunit. Tashti është te-

ipér vonë. I zoti i shtëpisë e ka pér detyrë  
të mos e lëshojet mikun. Ai i del rrezikut për-  
para me krahatar dhe e mbron mikun. (Pa-  
pritur dëgjohet një batare pushkësh, piska-  
më dhe kënga e majekrahit.)

«Sulë Pota i Oruç Hasës,  
Mblidhi djelm e sulu Pashës...»

**HANMI I PASHËS** — (Ngre kryet e tmerruar.) Bobo! Na hynë brenda!

**ABDULLA DRENI** — (Qëllon me pushkë.) Në këtë shtëpi jam zot unë. (Bie.)

**MAXHAR PASHA** — (Niset kah dera.) Ja ku më keni Lailaheil allah ve Muhamedyne resulullah! (Duke u falur bie edhe ai. Pamja errësohet, në mes të piskamëve e të shtënave.)

**Dukja 5** — Malësorë, Hanmi i Pashës, Mehmet Ali Dreni, Mic Sokoli, Toni i Prenkës, Sulë Vokshi e të tjerët.

**MALESORI I** — Ky paska qenë Maxhar Pasha!

**MALESORI II** — Edhe në çastin e vdekjes u rrekë me na rrejtë me shehadetin e tij.

**MALESORI III** — Po këta shka janë? Nuk shoh dot nga tymi.

**HANMI I PASHËS** — Unë jam grua, ky është im bir. Veni dorë në zemër.

**MALESORI II** — Mos u tut, ne nuk vrashim gra dhe fëmijë. Merri, o Mujë Muhaxhiri këta fëmijë e nxirri jashtë, se do të mbyten nga tymi.

(Mujë Muhaxhiri t' merr Hanmin e Pashës  
dhe Mehmet Ali Drenin dhe dalin.)

MALESORI I. — Ky qenka Abdulla Drenit. Paska  
marrë një plagë të madhe në kofshë. Po ky?

MALESORI III. — Bajram aga i vdekur. Që edhe  
bajraktari ynë, Shaqir aga. Qenka gjallë. O  
burra ta nxjerrim jashtë.

MALESORI II. — Të gjithë ne këtu jemi tanët. Ta  
mbulojmë me një gunë. (I hedh gunën përsiprë.  
Hynë malesorë të tjerë. Tymi është  
shtilar.)

MALESORI IV. — Paska shumë tym. Po ju atje shka  
mbuloni, o burra!

MALESORI II. — Një shok të plagosur.

MALESORI V. — Këtu paska vdekur bajraktari ynë.  
Haj, o Bajram aga, për një nishan bimbashi e  
le Kokën, në sarajet e Abdulla Drenit.

MALESORI VI. — Mos pa bëni ndonjë dredhi, or  
burra. Druaj se ai i mbuluari me gunë është  
bajraktari juaj, Shaqir aga. Pa zbuloheni ta  
shkojmë.

MALESORI III. — Mos e prek, se ta shkrepë.

MALESORI VI. — As unë nuk ta kursej.

MALESORI I. — Me ngadale, bre burra, se kështu  
do të vritemi. (Ndërkoqë hyn Mic Sokoli  
dhe drejtohet të malesorët që po grinden  
mbi trupin e Shaqir agës të mbuluar me  
gunë.)

MIC SOKOLI — Shkarkeni që po grinden. A nuk  
e lidhëm besën fis me fis dhe i lamë gjaqet  
vjetra?

MALESORI V. — Por ne e lidhëm besën që të mos  
fotalemëtë gjallë asnjë tradhtar, të ngujuar në

saraje me Maxhar Pashën. Edhe bajraktarët tanë...

MIC SOKOLI — Fjala, fjale, e besa, besë.

MALESORI V — Atëhere le ta zbulojnë atë shaku-llin që kanë mbuluar me gunë. Është një shok i plagosur apo Shaqir aga, që kërkoni me na e mëshefë. Që ku është bajraktari i vrarë? Ai atje është bajraktari juaj.

MALESORI III — Ne nuk e lëshojmë.

MALESORI VI — As ne nuk e lemë të dalë i gjallë nga konaku. Për këtë zjarr vritemi! (Malësorët i drejtojnë hutat njeri-tjetrit. Mic Sokoli, hyn në mes të tyre.)

MIC SOKOLI — Mos, bre, burra, se kështu do të na shtini përsëri në gjak. Këtë punë do ta kryej unë. (Nxjerr calinat nga brezi.) Më mirë, të digjen dy bajraktarët se dy bajràkë. (I shtie Shaqir agës të mbuluar me gunë.) Nuk kisha si t'jabej ndryshe, o i pari i fisisit. Ti vetë më the me t'i shprazë këto dy calinat e tua, në kraharor, po t'i thyeje besën fisisit. Dhë unë t'u binda. (Malësorëve.) Delni jastë, o burrat e dheut dhe lajmëroni, miletin-se lufta mbaroi. (Sarajet flakerojnë, Hyn Tonni i Prenkës me rrëmbim.)

TONI I PRENKËS — Sarajet po digjen, o Mic Sokoli, nxito të dalim jashtë. (Mic Sokoli nuk lëviz, Toni i Prenkës afrohet.) Shka ka qërrsi si i mpitë, bre burra?

MIC SOKOLI — Me dorën time vrava të parin e fisisit, Shaqir agën.

TONI I PRENKËS — A duhej ta vrisjeti domosdo?

**MIC SOKOLI** — Rol të mos ke vrisja është do ta bëni-  
ste një malësor i fisit tjeter dhe do të binim  
në gjak.

**TONI I PRENKËS** — Edhe u më përmirëardhë deri te  
tim që m'ua dësh ta kapërtë kur minë pasqirt  
të tim kunati, Hoshit të Nurit. (*Te dera e  
jashtme hyn Sulë Vokshi i ndjekur nga di-  
sa malësorë, ndër ta edhe këngëtari me lahu-  
të.*)

**SULË VOKSHI** — Që ai i huaji, Maxhar Pasha, dhe  
ky tradhtari ynë na ndanë, na vranë, na su-  
all këtë gjëmë. Ata deshën me çdo kusht të  
na lenë në një rrugë pa krye, në errësirë...  
Por kombi shqiptar është i vendosur të dalë  
në dritë. Dhe Lidhja e tij ka gjetur rrugën  
që do të na shpjerë në Shqipërinë e lirë.

**MIC SOKOLI** — A do të kemi rrugë të gjatë?

**TONI I PRENKËS** — Që të mbërrimë në Shqipëri-  
në e lirë, duhet të shkojmë nëpër shumë shti-  
gje të vështira e nëpër saraje të tjera me  
flakë. Ky është vetëm fillimi.

**SULË VOKSHI** — (*I kap për supash dy të tjerët:*)  
Vërtet fillimi, por që tashti e shohim qartë  
se e tumbarëm polemin në një rrugë të  
drejtë. Prandaj nuk na vjen keq edhe sikur  
të vdesim. Nga theroria jonë do të rilindë  
Shqipëria.

## KENGETARI — (*Këndon me lahutë:*)

«Krisi pushka, u dridh Gjakova,  
Në kambë u çua Rrafshi dhe Kosova,  
Besa-besë asht lidhun sot trimnia!  
Nji pëllambë tokë s'e lëshon Shqipnja!»

Mbarim